

**UNION BANK SH.A.**  
**Raporti i Audituesit te Pavarur**  
**dhe Pasqyrat Financiare Individuale**  
**me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016**

**PERMBAJTJA**

**Faqja**

**RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**

**PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE:**

<b>PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA INDIVIDUALE E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN AKSIONAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE MONETARE</b>	<b>4</b>
<b>SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE</b>	<b>5 – 55</b>



**Deloitte.**

Deloitte Audit Albania sh.p.k  
Rr. Elbasanit.  
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-  
Miniera  
Tirana, Albania  
Tel: +355 4 45 17 920  
Fax: +355 4 45 17 990  
www.deloitte.al

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Aksionarëve dhe Drejtimit të Union Bank Sh.a.,**

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Union Bank sh.a (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016 dhe pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më datë 31 dhjetor 2016 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

**Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)**

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania sh.p.k.*

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,

Tirana, Shqipëri

Numër identifikimi i personit të tatueshëm (NIPT): L41709002H



*Elvis Ziu*

Partner Angazhimi

Elvis Ziu

Auditues Ligjor

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2017

**Union Bank sh.a**  
**Pasqyra Individuale e Pozicionit financiar me 31 dhjetor 2016**

(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek)

	Shenime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Aktivet</b>			
Arka dhe llogari me Banken Qendrore	5	4,625,417	2,935,534
Depozita dhe llogari me bankat	6	2,899,375	4,125,609
Bono Thesari mbajtur deri ne maturim	7	1,539,380	1,760,774
Obligacione mbajtur deri ne maturim	8	14,032,927	11,962,869
Hua dhe paradhenie per institucionet financiare	9	985,598	436,296
Hua dhe paradhenie per klientët	10	15,686,308	15,155,719
Investime ne filiale	11	161,002	161,002
Aktive te patrupezuara	12	101,878	116,902
Aktive te trupezuara	13	209,770	195,198
Investim ne pasuri te paluajtshme	14	372,790	347,944
Aktive te tjera	15	820,626	829,745
Tatim fitim i arketueshem	29	18,196	-
Aktive tatimore te shtyra	29	8,313	4,110
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>41,461,580</b>	<b>38,031,702</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj Bankes Qendrore	16	2,168,572	1,317,562
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	17	1,394,562	1,314,162
Detyrime ndaj klienteve	18	34,093,972	31,618,267
Detyrime te tjera	19	245,792	349,516
Detyrim per tatim fitimin	29	-	48,830
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>37,902,898</b>	<b>34,648,337</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	20	2,717,813	2,717,813
Primi i aksionit		175,600	175,600
Rezerva ligjore	20	271,906	117,733
Fitimi i akumuluar		393,363	372,219
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>3,558,682</b>	<b>3,383,365</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>41,461,580</b>	<b>38,031,702</b>

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet nga faqja 5 deri ne faqen 55, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave individuale financiare.

Keto pasqyra individuale financiare jane aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv me 29 mars 2017 dhe u nenshkruan ne emer te tij nga:



Gazmend Kadriu  
Drejtor i Pergjithshem




Arten Zikaj  
Drejtor i Divizionit te Finances

**Union Bank sh.a****Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe te Ardhurave te Tjera Permbledhese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek)*

	Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2015
Te ardhura nga interesat	21	1,974,406	2,033,759
Shpenzime per interesat	22	(406,593)	(539,952)
<b>Te ardhura neto nga interesat</b>		<b>1,567,813</b>	<b>1,493,807</b>
Humbje neto nga zhvleresimi i huave	9,10	(425,487)	(278,189)
<b>Te ardhura neto nga interesat pas zhvleresimit te huave</b>		<b>1,142,326</b>	<b>1,215,618</b>
Te ardhura nga komisionet	23	218,091	187,242
Shpenzime per komisionet	24	(31,955)	(26,759)
<b>Te ardhura neto nga komisionet</b>		<b>186,136</b>	<b>160,483</b>
Rezultati neto nga veprimet valutore	25	10,530	(11,422)
Ndryshimet e vleres se drejte te investimeve ne pasuri	14	(19,167)	(12,143)
Ndryshimi i vleres se realizueshme te kolateraleve te marra nepermjet nje procesi ligjor	15	(9,445)	(6,737)
Te ardhura nga qiradhenia e pasurive te paluajtshme	14	3,168	20,161
Te ardhura te tjera, neto	26	16,242	106,382
Shpenzime te tjera per provigjone		(16,496)	-
Amortizimi i aktiveve te patrupezuara	12	(25,779)	(32,189)
Amortizimi i aktiveve te trupezura	13	(40,736)	(39,016)
Shpenzime personeli	27	(424,327)	(384,614)
Shpenzime te tjera administrative	28	(612,390)	(575,310)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>210,062</b>	<b>441,213</b>
Tatimi mbi fitimin	29	(34,745)	(68,994)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>175,317</b>	<b>372,219</b>
<b>Te ardhura te tjera permbledhese, neto nga tatimi</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i te ardhurave permbledhese per vitin</b>		<b>175,317</b>	<b>372,219</b>

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera permbledhese duhet te lexohet se bashku me shenimet nga faqja 5 deri ne faqen 55, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave individuale financiare.

**Union Bank sh.a**

**Pasqyra Individuale e Ndryshimeve ne Kapitalin Aksionar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016**

*(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek)*

Shenime	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Rezerva ligjore	Fitimi i akumuluar	Totali
<b>Gjendja me 1 janar 2015</b>	<b>2,579,853</b>	<b>175,600</b>	-	<b>117,733</b>	<b>2,873,186</b>
<b>Veprimet me pronaret regjistruar direkt ne kapital</b>					
Kontribute te dhe shperndarje per pronaret					
Kontribut per rritjen e kapitalit	20	137,960	-	-	<b>137,960</b>
Rezerva Ligjore	20	-	-	117,733	(117,733)
<b>Totali i kontributeve te dhe per pronaret</b>		<b>137,960</b>	-	<b>117,733</b>	<b>137,960</b>
<b>Totali i te ardhurave permbledhese per vitin</b>					
Fitimi i vitit		-	-	-	372,219
Te ardhura te tjera permbledhese neto nga tatimi		-	-	-	-
<b>Totali i te ardhurave permbledhese per vitin</b>		-	-	-	<b>372,219</b>
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,717,813</b>	<b>175,600</b>	<b>117,733</b>	<b>372,219</b>	<b>3,383,365</b>
<b>Veprimet me pronaret regjistruar direkt ne kapital</b>					
Kontribute te dhe shperndarje per pronaret					
Kontribut per rritjen e kapitalit		-	-	-	-
Rezerva Ligjore	20	-	-	154,173	(154,173)
<b>Totali i kontributeve te dhe per pronaret</b>		-	-	<b>154,173</b>	<b>(154,173)</b>
<b>Totali i te ardhurave permbledhese per vitin</b>					
Fitimi i vitit		-	-	-	175,317
Te ardhura te tjera permbledhese neto nga tatimi		-	-	-	-
<b>Totali i te ardhurave permbledhese per vitin</b>		-	-	-	<b>175,317</b>
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,717,813</b>	<b>175,600</b>	<b>271,906</b>	<b>393,363</b>	<b>3,558,682</b>

Pasqyra individuale e ndryshimeve ne kapitalin aksionar duhet te lexohet se bashku me shenimet nga faqja 5 deri ne faqen 55, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave individuale financiare.

**Union Bank sh.a**
**Pasqyra Individuale e Flukseve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016**
*(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek)*

Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2015
<b>Flukset e parase nga aktiviteti operativ:</b>		
Fitimi para tatimit	210,062	441,213
<b>Rregullime per zerat jo-monetare:</b>		
Te ardhura nga interesi	21 (1,974,406)	(2,033,759)
Shpenzime interesi	22 406,593	539,952
Amortizimi i aktiveve te trupëzuara	13 40,736	39,016
Amortizimi i aktiveve te patrupezuara	12 25,779	32,189
Humbje neto nga zhvleresimi i kredive	9,10 425,487	278,189
Ndryshimi i vleres se realizueshme te kolateraleve te marra nepermjet nje procesi ligjor	15 9,445	6,737
Ndryshimet e vleres se drejte te investimeve ne pasuri	14 19,167	12,143
Efekti i rivleresimit te parase dhe ekuivalenteve te saj	56,628	(1,728)
Efekti i rivleresimit te tjera	24,645	13,264
Nxjerrje jashte perdorimit te aktiveve te trupezuara	1,383	11,553
Shitja e aktiveve te trupezuara	(85)	-
Fitimi neto nga shitja e aktiveve te mbajtura per shitje	(8,081)	(95,407)
	<b>(762,647)</b>	<b>(756,638)</b>
<b>Ndryshimet ne:</b>		
Depozita dhe llogari me bankat	64,607	(232,211)
Hua dhe paradhenie per institucionet financiare	(556,581)	(433,450)
Hua dhe paradhenie per klientet	(991,894)	(1,472,234)
Aktive te tjera	(38,565)	(252,121)
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	81,421	76,936
Detyrime ndaj klienteve	2,578,072	1,672,231
Detyrime ndaj Bankes Qendrore	851,327	191,767
Detyrime te tjera	(103,724)	172,314
Interesi i marre	1,971,477	2,049,214
Interesi i paguar	(510,298)	(532,591)
Tatim fitimi i paguar	(105,974)	(43,000)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktiviteti operativ</b>	<b>2,477,221</b>	<b>440,217</b>
<b>Flukset e parase nga veprimtarite investuese:</b>		
Blerja e aktiveve te patrupezuara	12 (10,755)	(17,661)
Blerja e aktiveve te trupezuara	13 (59,893)	(53,014)
Blerja e kolateraleve te marra nepermjet nje procesi ligjor	15 -	(233,376)
Investime ne filiale	-	182,816
Arketime nga shitja e aktiveve te trupezuara	1,440	-
Arketime nga shitja e kolateraleve te marra nepermjet nje procesi ligjor	20,114	676,471
Blerja e bonove te thesari mbajtur deri ne maturim	171,489	352,069
Blerja e obligacioneve te thesari mbajtur deri ne maturim	(2,064,532)	(1,781,565)
<b>Paraja neto e perdorur per aktivitetet investuese</b>	<b>(1,942,137)</b>	<b>(874,260)</b>
<b>Flukset e parase nga veprimtarite financuese</b>		
Shlyerje e borxhit te varur	-	(1,051)
Rritja ne kapitalin e paguar	-	137,960
<b>Flukset e parase nga veprimtarite financuese</b>	<b>-</b>	<b>136,909</b>
<b>Renie neto ne para dhe ekuivalentet e saj gjate vitit</b>	<b>535,084</b>	<b>(297,134)</b>
Efekti i rivleresimit te parase dhe ekuivalenteve te saj	(56,628)	1,728
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fillim te vitit</b>	<b>4,767,030</b>	<b>5,062,436</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj ne fund te vitit</b>	<b>30 5,245,486</b>	<b>4,767,030</b>

Pasqyra individuale e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet nga faqja 5 deri ne faqen 55, te cilat jane pjese perberese te ketyre pasqyrave individuale financiare.

## **1. HYRJE**

Union Bank Sh.a. (“Banka”) eshte nje institucion financiar i regjistruar si banke tregtare me 9 janar 2006 bazuar ne Vendimin nr. 101, date 28 dhjetor 2005 te Bordit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise (BSH). Aktiviteti i Bankes i nenshtrohet Ligjit nr. 8269 date 23 dhjetor 1997 “Per Banken e Shqiperise”, Ligjit nr. 9662 date 18 dhjetor 2006 “Per Bankat ne Republiken e Shqiperise” si dhe ne perputhje me te gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Keshilli Mbikeqyres i Bankes se Shqiperise.

Banka eshte nje banke tregtare, e cila ofron sherbime bankare per individe dhe kompani ne Republiken e Shqiperise. Banka eshte regjistruar si shoqeri aksionare me numer regjistrimi 33563 date 26 maj 2005, date ne te cilen Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencen per aktivitete bankare me 9 janar 2006.

Bazuar ne marreveshjen e shitblerjes te nenshkruar me shtator 2014, ne 22 dhjetor 2014, Banka bleu 100% te aksioneve te Landeslease Sh.a. (“Filiali”), dhe eshte aksionari i vetem i ketij institucioni financiar. Filiali eshte nje shoqeri lizingu shqiptar, e regjistruar si nje shoqeri aksionare, e cila u regjistrua dhe filloi te operonte ne 5 Prill 2005.

Keto pasqyra jane pasqyra individuale financiare te Bankes (“Mema”). Pergatitja e ketyre pasqyrave financiare individuale kerkohet nga legjislacioni tatimor vendas. Pervec ketyre pasqyrave, Banka pergatit pasqyra financiare te konsoliduara ne perputhje me kërkesat e SNRF 10. Ato pasqyra financiare te konsoliduara jane te Bankes dhe Filialit te saj (se bashku “Grupi”). Pasqyrat financiare te Filialit perfshihen ne pasqyrat financiare te konsoliduara duke filluar nga data ne te cilen fillon ushtrimi i kontrollit te Bankes mbi te e deri ne daten ne te cilen ky kontroll pushon se ekzistuar (shih shenimin 2.4).

Selia Qendrore e Bankes ndodhet ne Tirane, Shqiperi.

Ne 31 dhjetor 2016 Banka operonte me nje rrjet prej 30 degesh (31 dhjetor 2015: 29) net e gjithe Shqiperine.

## **Drejtuesit dhe administrimi i Bankes me 31 dhjetor 2016**

### *Bordi Drejtues (Keshilli Mbikeqyres)*

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anetar
Paul Nabavi	Anetar
Gazmend Kadriu	Anetar
Sokol Marishta	Anetar
Flutura Veipi	Anetar

Znj. Flutura Veipi iu bashkua Bordit ne date 5 tetor 2016, duke zevendesuar Z. Genc Turku

### *Komiteti i Kontrollit*

Varuzhan Piranjani	Kryetar
Mirela Lika	Anetar
Matilda Shehu	Anetar

### *Drejtimi Ekzekutiv*

Gazmend Kadriu	Drejtor i Pergjithshem
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit te Operacioneve
Ardian Petollari	Drejtor i Divizionit te Biznesit
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit te Finances
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit te Kredise

## **2. BAZA E PERGATITJES**

### **2.1 Deklarata e perputhshmerise**

Pasqyrat individuale financiare te Bankes jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te nxjerra nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

### **2.2 Baza e pergatitjes**

Pasqyrat individuale financiare te Bankes jane pergatitur mbi bazen e kostos historike me perjashtim te Pasurive te paluajtshme te mbajtura per investim, te cilat maten me vleren e drejte.

### **2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit**

Keto pasqyra individuale financiare te Bankes jane paraqitur ne Lek Shqiptar (Lek), e cila eshte monedha funksionale e Bankes. Gjithe informacioni i paraqitur ne Lek eshte rrumbullakosur ne mijeshen me te afert, pervecse kur eshte shprehur ndryshe.

### **2.4 Pasqyrat individuale financiare**

Banka e regjistron investimin ne Filialin e saj (Shenimi 1) me kosto. Banka njeh dividendet e marre nga Filiali ne fitim ose humbje ne pasqyrat e saj financiare individuale kur e drejta per te marre dividendet eshte permbushur.

Banka ka aplikuar te gjitha SNRF-te ne fuqi ne paraqitjen e shenimeve sqaruese ne pasqyrat financiare individuale.

Filialet jane investime te kontrolluara nga Grupi. Grupi 'kontrollon' nje investim nese eshte i ekspozuar ndaj, apo ka te drejta mbi kthimin e ndryshueshem nga perfshirja ne investim dhe ka mundesine per te ndikuar mbi kete kthim nepermjet pushtetit te tij mbi investimin. Keto perfshijne rrethana ne te cilat te drejtat mbrojtese te patura (psh. ato qe rezultojne nga nje marredhenie kredidhenie) behen te rendesishme dhe bejne qe Grupi te kete pushtet mbi investimin.

Banka, ne perputhje me SNRF-te pergatit, gjithashtu, dhe pasqyra financiare te konoliduara per Grupin. Pasqyrat financiare te konsoliduara mund te gjenden ne <https://unionbank.al/>. Perdoruesit e ketyre pasqyrave financiare individuale duhet t'i lexojne se bashku me pasqyrat financiare te konsoliduara te Grupit per vitin te mbyllur me 31 dhjetor 2016, ne menyre qe te sigurojne nje informacion te plote mbi pozicionin financiar, rezultatet operacionale dhe ndryshimeve ne pozicionin financiar te Grupit si nje te tere.

### **2.5 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve**

Pergatitja e pasqyrave financiare individuale ne perputhje me SNRF-te kerkon qe Drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet baze rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe afektohen/preken nga keto ndryshime. Drejtimi beson se vleresimet dhe supozimet baze jane te duhura dhe se, si rrjedhoje, pasqyrat financiare individuale paraqesin sakte pozicionin dhe rezultatit financiar. Ne vecanti, informacioni rreth elementeve kryesore te pasigurise se vleresimeve dhe gjykimeve kritike per aplikimin e politikave kontabel te Bankes, qe kane efekt te rendesishem ne shumatat e njohura ne pasqyrat financiare individuale jane pershkruar ne shenimin 4.

### **2.6 Te dhena te krahasueshme**

Ne menyre qe te jepet nje prezantim dhe informacion me i mire, ne pasqyrat financiare individuale te vitit te mbyllur me 31 dhjetor 2016, jane bere riklasifikime te ndryshme te zerave dhe shenimeve mbi to.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL**

#### **3.1 Filiali dhe konsolidimi**

Filialet jane entitete te konrolluara nga Banka. Kontrolli egziston kur Banka ka fuqine, qe ne menyre direkte apo indirekte, te qeveise politikat financiare dhe operacionale te nje entiteti ne menyre qe te siguroje benefite nga aktivitetet e tij. Ne matjen e kontrollit, te drejta potenciale te votes qe jane te ushtrueshme apo te konvertueshme, merren ne konsiderate. Nje Banke nuk e ka te nevojshme prezantimin e pasqyrave financiare te konsoliduara nese vete eshte nje filial i zoteruar plotesisht dhe mema perfundimtare apo e ndermjetme publikon pasqyra financiare te konsoliduara te cilat jane ne perputhje me SNRF-te. Banka pergatit pasqyrat financiare individuale dhe te konsoliduara ne perputhje me SNRF-te. Filiali mbahet me kosto ne pasqyrat financiare individuale. Pasqyrat financiare te konsoliduara te pergatitura ne perputhje me SNRF-te do te publikohen ne te njejten date me pasqyrat financiare individuale.

#### **3.2 Transaksionet ne monedhe te huaj**

Veprimet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Zerat monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne ate date. Fitim/humbja nga monedhat e huaja per zerat monetare eshte diferenca midis koston se amortizuar ne monedhen funksionale ne fillim te vitit, e axhustuar per interesin efektiv dhe pagesat gjate vitit, dhe koston se amortizuar ne monedhe te huaj te konvertuar me kursin e kembimit ne fund te vitit.

Aktivet dhe pasivet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten ne te cilen eshte percaktuar vlere e drejte. Zerat jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me kosto historike jane konvertuar duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Diferencat qe vijne nga kurset e kembimit e prej konvertimeve jane njohur pergjithesisht ne pasqyren individuale te te ardhurave permbledhese. Fitim/ humbjet neto nga kembimi perfshijne te gjitha diferencat nga kurset e kembimit qe kane te bejne me transaksionet spot me date likuidimi dy dite pune pas dates se veprimit, megjithese keto transaksione njihen ne daten e likuidimit.

#### **3.3 Interesat**

Te ardhurat dhe shpenzimet per interesa jane njohur ne pasqyren individuale te te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden e normes efektive te interesit. Norma efektive e interesit eshte norma, me te cilen skontohen ekzaktesisht pagesat e vleresuara te ardhshme te mjeteve monetare ose arketimet pergjate jetes se pritshme te instrumentit financiar (ose kur eshte e pershtatshme, per periudhen me te shkurter) duke arritur ne vleren kontabel neto te aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar. Gjate perlllogaritjes se normes efektive te interesit, Banka vlereson flukset e ardhshme te parase duke marre ne konsiderate kushtet kontraktuale te instrumenteve financiare, por jo humbjet e ardhshme te kredise.

Te ardhurat dhe shpenzimet per interesa ne pasqyren individuale te te ardhurave dhe shpenzimeve dhe te te ardhurave te tjera permbledhese, perfshijne interesa ne aktivet dhe detyrimet financiare qe maten me koston e amortizuar te llogaritur me metoden e normes efektive te interesit.

#### **3.4 Te ardhura dhe shpenzime per komisione**

Te ardhurat dhe shpenzimet per komisione qe jane pjese e normave efektive te interesave te nje aktivi apo detyrimi financiar perfshihen ne matjen e normes efektive te interesit.

Te ardhurat e tjera nga komisionet, duke perfshire komisionet per mirembjtje llogarie, komisione per manaxhimin e investimeve, komisione shitje dhe vendosje, njihen gjate kryerjes se sherbimeve te lidhura me to. Kur nje angazhim per kreditim nuk pritet te rezultojte ne terheqje te kredise, komisionet e kredise perkatese, njihen ne baze lineare gjate periudhes se angazhimit.

Shpenzimet e tjera per komisione lidhen kryesisht me komisione per transaksione dhe sherbime, te cilat regjistrohen si shpenzime ne momentin e marrjes se sherbimit.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIMI)**

#### **3.5 Shpenzimet per qira**

Totali i pagesave te bera per qirate operacionale njihet ne pasqyren e fitim humbjeve sipas metodes lineare pergjate jetes se qirase. Zbritjet nga qiraja njihen si pjese perberese e totalit te shpenzimeve per qira, pergjate afatit te qirase.

#### **3.6 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin e vitit permban tatimin e vitit aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren individuale te fitim ose humbjeve te periudhes me perjashtim te rasteve qe lidhen me zera qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese.

##### **3.6.1 Tatimi aktual**

Tatimi aktual eshte shuma e pagueshme ose e arketueshme ne lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme per vitin, duke perdorur normat ne fuqi ne daten e raportimit, dhe ndonje axhustim per tatimin e pagueshem ne lidhje me vitet e meparshme.

##### **3.6.2 Tatimi i shtyre**

Tatimi i shtyre njihet mbi diferencat e perkohshme qe rezultojne midis bazes tatimore dhe vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve ne pasqyrat financiare individuale. Tatimi i shtyre nuk njihet per diferencat e perkohshme qe lindin ne momentin e njohjes fillestare te aktiveve ose detyrimeve ne nje transakcion qe nuk eshte nje kombinim biznesi dhe qe nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabel dhe as ate te tatueshme.

Matja e tatimit te shtyre pasqyron pasojat tatimore qe do te ndjekin menyren ne te cilen Banka pret, ne fund te periudhes raportuese, per te rimarre ose te shlyeje vleren kontabel te aktiveve dhe pasiveve te saj.

Tatimi i shtyre eshte matur me normat e tatimit qe pritet te aplikohen mbi diferencat e perkohshme ne periudhen kur detyrimi eshte likuiduar apo aktiv i eshte realizuar, bazuar ne normat tatimore e ligjore ne fuqi ne daten e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet tatimore te shtyra kompesojne njera-tjetren kur ka nje te drejte ligjore te zbatueshme per te kompesuar aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi te ardhurat te vena nga i njejti autoritet i taksave.

Taksat shtese qe rrjedhin nga shperndarja e dividendeve nga Banka njihen ne te njejten kohe kur njihet detyrimi per te paguar dividendet.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per humbjet/kreditet e mbartura dhe diferencat e perkohshme te zbritshme, deri ne masen qe eshte i mundur qe te kemi te ardhura te tatushme kundrejt te cilave ky aktiv tatimor pritet te perdoret. Aktiv i tatimor i shtyre rishikohet ne cdo periudhe raportimi dhe zvogelohet deri ne masen qe nuk ka mundesi qe perfitimi i lidhur nga tatimi te mund te realizohet.

##### **3.6.3 Ekspozimet tatimore**

Ne percaktimin e shumes se tatimit aktual dhe te shtyre, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore te pasigurta dhe nese taksa apo interesa shtese mund te jene te pagueshme. Ky vleresim mbeshtetet ne vleresimet dhe supozimet dhe mund te perfshije nje sere gjykimesh ne lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacionet e reja mund te behen te disponueshme dhe te bejne qe Banka te ndryshoje vendimin e saj ne lidhje me pershtatshmerine e detyrimeve tatimore ekzistuese; keto ndryshime ne detyrimet tatimore do te ndikojne shpenzimet tatimore ne periudhen ne te cilen eshte bere nje percaktim i tille.

### **3.7 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare**

#### **3.7.1 Njohja**

Banka fillimisht njeh huate dhe paradheniet, depozitat, dhe borxhin e varur ne daten qe ato jane emetuar. Blerjet apo shitjet e aktiveve financiare njihen ne daten e tregtimit ne te cilen Banka merr angazhimin per te blere ose shitur aktivin. Te gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht ne daten e tregtimit, e cila eshte data kur Banka behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Nje aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vleren e drejte plus kostot e transakcionit qe lidhen drejtperdrejt me blerjen apo leshimin e tij.

#### **4. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIMI)**

##### **3.7 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdimi)**

###### **3.7.2 Klasifikimi**

###### ***Aktivet financiare***

Banka klasifikon aktivet e saj financiare ne nje nga kategorite e meposhtme:

- Hua dhe llogari te arketueshme
- Te mbajtura ne maturim.

Shih shenimet 3.8, 3.9 dhe 3.10.

###### ***Detyrimet financiare***

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si te matura me kosto te amortizuar. Shih shenimin 3.16.

###### **3.7.3 Çregjistrimi**

###### ***Aktivet financiare***

Banka çregjistron nje aktiv financiar kur mbarojne te drejtat kontraktuale te flukseve te mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose ajo transferon te drejtat per te marre flukse mjeteve monetare kontraktuale ne nje transaksion ne te cilin kryesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise te aktivitet financiar jane transferuar ose ne te cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise dhe nuk mban kontrollin e aktivitet financiar. Çdo interes qe eshte krijuar ose mbahet nga Banka mbi aktivet financiare te transferuara qe kualifikohen per çregjistrim, njihet si nje aktiv apo detyrim i veçante.

Ne momentin e çregjistrimit te nje aktivi financiar, diferenca midis vleres kontabel neto te aktivitet (ose vlera kontabel qe i perket pjeses se aktivitet te transferuar), dhe totalit te (i) konisderates se marre (perfshire çdo aktiv te ri te perftuar minus ndonje te pakesim ne detyrime) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative qe eshte njohur ne te ardhura te tjera te pergjithshme, njihet ne fitim ose humbje.

Banka hyn ne transaksione ku ajo transferon aktive te njohura ne pasqyren individuale te pozicionit financiar, por ruan ose te gjitha ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet te transferuar ose nje pjese te tyre. Nese te gjitha apo thujse te gjitha rreziqet dhe perfitimet mbahen, atehere aktivet e transferuara nuk çregjistrohen. Transferimi i aseteteve per te cilat mbahen te gjitha ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet perfshijne, per shembull, transaksionet e riblerjes.

Ne transaksione ne te cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon thujse te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise te nje aktivi financiar dhe ruan kontrollin mbi aktivin, Banka vazhdon ta njohe aktivin ne masen e perfshirjes se vazhdueshme, qe percaktohet nga masa ne te cilen eshte e ekspozuar ndaj ndryshimeve ne vleren e aktivitet te transferuar.

###### ***Detyrimet financiare***

Banka çregjistron nje detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale jane permbushur, nderprere apo perfunduar.

###### **3.7.4 Kompesimi**

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren individuale te pozicionit financiar, atehere, dhe vetem atehere kur Banka ka te drejten ligjore per te kompesuar shumat dhe ajo synon ose te shlyeje ato ne nje baze neto, ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin njekohesisht.

Te ardhurat dhe shpenzimet paraqiten ne baze neto vetem atehere kur lejohet sipas SNRF, ose per fitimet dhe humbjet e krijuara nga nje grup transaksionesh te ngjashme si per shembull ato te aktivitetit tregtar te Bankes.

###### **3.7.5 Matja me kosto te amortizuar**

Kosto e amortizuar e nje aktivi ose detyrimi financiar eshte vlera me te cilen aktivi ose detyrimi financiar matet ne njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke perdorur metoden e interesit efektiv per çdo diference ndermjet vleres fillestare te njohur dhe vleres ne maturim, minus çdo zbritje per efekt zhvleresimi.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.7 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### **3.7.6 Matja e vleres se drejte**

'Vlera e drejte' eshte çmimi me te cilin aktivi mund te shitet, ose nje pasiv te transferohet, ne nje transakcion te zakonshem mes pjesemarresve ne treg ne daten e matjes, ne nje treg primar ose ne mungese te tij, ne tregun me te favorshem ne te cilin Banka ka akses ne ate date. Vlera e drejte e nje detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit te tij.

Kur eshte e mundur, Banka mat vleren e drejte te nje instrumenti duke perdorur çmim te kuotuar ne nje treg aktiv per ate instrument. Nje treg quhet aktiv ne qofte se transakcionet ne lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuence dhe volum te mjaftueshme per te siguruar informacion te çmimeve ne baza te vazhdueshme.

Nese nuk ekziston nje çmim i kuotuar ne nje treg aktiv, atehere Banka perdor teknika vleresimi te cilat maksimizojne perdorimin te inputeve perkatese te vezhgueshme dhe minimizojne perdorimin e inputeve jo te vezhgueshme. Teknika e zgjedhur e vleresimit perfshin te gjitha faktoret qe pjesemarresit ne treg do te kishin parasysh ne vendosjen e çmimit te nje transakcioni.

Evidenca me e mire e vleres se drejte te nje instrumenti financiar ne njohjen fillestare te tij eshte zakonisht çmimi i transakcionit - dmth vlera e drejte e konsiderates se dhene ose te marre. Nese Banka percakton se vlera e drejte ne njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transakcionit dhe se vlera e drejte nuk eshte evidentuar as me nje çmim te kuotuar ne nje treg aktiv per nje aktiv ose detyrim identik e as nuk eshte e bazuar ne nje teknike vleresimi e cila perdor vetem te dhena nga tregjet e vrojtueshme, atehere instrumenti financiar matet fillimisht me vleren e drejte, rregulluar per te shtyre ne kohe diferencen midis vleres se drejte ne njohjen fillestare dhe çmimit te transakcionit. Me pas, kjo diference eshte njohur ne fitim ose humbje ne nje baze te pershtatshme mbi jetegjatesine e instrumentit, por jo me vone se vleresimi qe mbeshetet plotesisht nga te dhena te vezhgueshme te tregut ose kur transakcioni mbyllet.

Ne qofte se nje aktiv ose pasiv te matur me vleren e drejte ka nje çmim te ofruar dhe nje çmim te kerkuar, atehere Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata ne çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra ne çmim e kerkuar.

Vlera e drejte e nje llogarie kursimi nuk eshte me pak se shuma e pagueshme sipas kerkeses, skontuar nga data e pare kur mund te kerkohet pagimi i shumes.

Banka njeh transferimet midis niveleve te hierarkise se vleres se drejte deri ne fund te periudhes raportuese gjate te ciles ky ndryshim ka ndodhur.

##### **3.7.7 Identifikimi dhe matja e zhvleresimit**

Ne çdo date raportimi Banka vlereson nese ka evidence objektive qe aktivet financiare te cilat nuk mbahen me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes jane zhvleresuar. Nje aktiv financiar ose nje grup aktivesh financiare eshte zhvleresuar kur evidencia objektive demonstrojne se nje ngjarje qe sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivitet (aktiveve), dhe qe ngjarja qe sjell humbje ka nje ndikim ne flukset e ardhshme te parase se aktivitet (aktiveve) dhe qe mund te vleresohet me besueshmeri.

Evidencat objektive qe aktivet financiare jane te zhvleresuara mund te perfshijne veshtiresi te konsiderueshme financiare te huamarresit ose emetuesit, mospagesa nga nje huamarres, ristrukturimin e nje kredie nga Banka me kushte qe normalisht nuk do te konsideroheshin, te dhena qe nje huamarres ose emetues do te hyje ne faliment, zhdukjen e nje tregu aktiv per nje leter me vlere, ose te dhena te tjera te dukshme lidhur me nje grup aktivesh te tilla si ndryshime te pafavorshme ne statusin e pagesave te nje huamarresi ose emetuesi te letrave ne kete grup, ose kushte ekonomike qe lidhen me mospagimin ne kete grup.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.7 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### **3.7.7 Identifikimi dhe matja e zhvleresimit (vazhdim)**

Banka konsideron evidencen e zhvleresimit per huate dhe paradheniet dhe letrat e investimit te mbajtura deri ne maturim si individualisht ashtu dhe ne nivel kolektiv. Te gjitha huate dhe paradheniet dhe letrat e investimit te mbajtura deri ne maturim individualisht te rendesishme vleresohen per zhvleresim specifik. Ato per te cilet nuk gjendet zhvleresim specifik me pas vleresohen kolektivisht per ndonje zhvleresim qe ka ndodhur, por nuk eshte identifikuar ende. Huate dhe paradheniet dhe letrat me vlere te investimeve te mbajtura deri ne maturim qe nuk jane individualisht te rendesishme, vleresohen kolektivisht per zhvleresim duke i grupuar sipas karakteristika te ngjashme te rrezikut.

Per qellimet e nje vleresimi kolektiv te zhvleresimit, aktivet financiare grupohen ne baze te karakteristikave te ngjashme te rrezikut te kredise (lloji dhe shuma e kredise). Bazuar ne te dhenat historike per secilin prej ketyre grupeve eshte llogaritur nje koeficient humbjeje. Keta faktore te pritshem humbjeje jane te rregulluar ne baze te gjykimit te drejtuesve per te pare nese kushtet aktuale ekonomike dhe te kreditit jane te tilla qe humbjet aktuale kane te ngjare te jene me te medha ose me te vogla se ato qe sugjerohen nga tendencat historike, dhe pastaj ata jane aplikuar per te vleresuar humbjet nga zhvleresimi ne çdo grup.

Normat e humbjes dhe perkeqesimit dhe koha e pritshme e rekuperimit krahasohen rregullisht perkundrejt rezultateve aktuale per te siguruar qe ato te mbeten te pershtatshme.

Humbjet nga zhvleresimi te aktiveve te matura me kosto te amortizuar llogariten si diference midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara skontuar me normen fillestare efektive te interesit te aktivitetit.

Nese kushtet e nje aktiviteti financiar rinegocohen ose modifikohen ose nje aktiviteti ekzistues financiar eshte zevendesuar me nje te ri per shkak te veshtiresive financiare te huamarresit, atehere behet vleresimi nese aktiviteti financiar duhet te çregjistrohet. Nese flukset e mjeteve monetare te aktivitetit te rinegocuar jane thelbesisht te ndryshme, atehere te drejtat kontraktuale per flukse te mjeteve monetare nga aktiviteti financiar fillestar mendohet te kete skaduar. Ne kete rast aktiviteti fillestar financiar çregjistrohet dhe nje aktivitet i ri financiar njihet me vleren e drejte. Humbja nga zhvleresimi matet si me poshte:

- Nese ristrukturimi i pritshem nuk rezulton ne çregjistrimin e aktivitetit ekzistues, flukset e vleresuara monetare qe rrjedhin nga aktiviteti financiar i modifikuar perfshihen ne matjen e aktivitetit ekzistues bazuar ne kohen dhe shumet e pritshme te tyre te skontuara me normen origjinale efektive te interesit te aktivitetit financiar ekzistues.
- Nese ristrukturimi i pritshem rezulton ne çregjistrimin e aktivitetit ekzistues, atehere vlera e drejte e pritshme e aktivitetit te ri eshte trajtuar si pagesa e fundit nga aktiviteti financiar ekzistues ne daten e çregjistrimit te tij. Kjo shume eshte skontuar nga data e pritshme e çregjistrimit ne daten e raportimit, duke perdorur normen fillestare te interesit efektiv te aktivitetit financiar ekzistues.

Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje dhe pasqyrohen ne nje llogari provigjoni perkundrejt huave dhe paradhenieve apo letrave te investimit te mbajtura deri ne maturim. Interesat e aktiveve te zhvleresuara vazhdojne te njihen nepermjet skontimeve ne baza kohore. Kur nje ngjarje e ndodhur pas njohjes se zhvleresimit shkakton uljen e shume e humbjes nga zhvleresimi, ulja e humbjes nga zhvleresimi kthehet ne pasqyren e fitim humbjeve.

Banka fshin kredi dhe paradhenie dhe letrat me vlere te investimeve, kur ato jane te pambledhshme (shiko shenimin 33). Kredi te tilla fshihen, pasi te gjitha procedurat e nevojshme kane perfunduar dhe shuma e humbjes eshte percaktuar.

#### **3.8 Paraja dhe ekuivalentet e saj**

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne para ne arke, balanca ne Banken Qendrore te pakufizuara ne perdorim dhe aktive financiare shume likuide me maturim fillestar deri ne tre muaj te cilat, kane rrezik te pakonsiderueshem ndryshimi te vleres se tyre te drejte, dhe perdoren nga Banka per manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto te amortizuar ne pasqyren individuale te pozicionit financiar.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.9 Huate dhe paradheniet**

Huate dhe paradheniet jane aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme, te cilat nuk jane kuotuar ne tregje aktive dhe Banka nuk ka per qellim t'i shese menjehere apo ne nje periudhe afatshkurter. Huate dhe paradheniet per bankat dhe per klientet klasifikohen si hua dhe llogari te arketueshme.

Huate dhe paradheniet fillimisht maten me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe ne vijim maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Kur Banka blen nje aktiv financiar dhe njeheresh hyn ne nje marreveshje per ta rishitur kete aktiv (ose nje aktiv thelbesisht te ngjashem) me nje çmim fiks ne nje date te ardhshme (repo te anasjellta), marreveshja kontabilizohet si nje hua apo paradhenie dhe aktivi i lidhur me te nuk njihet ne pasqyrat individuale financiare te Bankes.

#### **3.10 Letrat me vlere te investimit te mbajtura deri ne maturim**

Letrat me vlere te investimit maten fillimisht me vleren e drejte plus kostot direkte te transaksionit, dhe me pas llogariten ne varesi te klasifikimit te tyre si te mbajtura deri ne maturim.

Investimet e mbajtura deri ne maturim jane aktive jo-derivative me pagesa fikse ose te percaktueshme dhe maturitet fiks qe Banka ka qellimin dhe mundesine per t'i mbajtur deri ne maturim, dhe te cilat nuk jane percaktuar si letra me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes ose si te vlefshme per shitje.

Investimet e mbajtura deri ne maturim mbahen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, duke i zbritur ndonje humbje nga zhvleresimi (shih shenimin 3.7.7). Nje shitje ose riklasifikim i nje sasive te konsideruar si jo e paperfillshme prej investimeve te mbajtura deri ne maturim, do te rezultonte ne riklasifikimin e te gjitha investimeve te mbajtura deri ne maturim si te disponueshme per shitje dhe do te ndalonte Banken te klasifikonte letrat me vlere investimi si te mbajtura deri ne maturim per vitin aktual dhe per dy vitet financiare pasuese.

Megjithate, shitjet dhe riklasifikimet e ndodhura ne ndonje prej rrethanave te meposhtme nuk do te shkaktonin nje riklasifikimin:

- shitje ose riklasifikimeve qe jane aq afer maturimit sa qe ndryshimet ne normen e tregut te interesit nuk do te kete nje efekt te rendesishem ne vleren e drejte te aktivitetit financiar;
- shitje ose riklasifikimeve pasi Banka ka mbledhur ne thelb te gjitha principalin origjinal te aktivitetit; dhe
- shitje ose riklasifikimeve qe i atribuohen ngjarjeve jo te perseritura te izoluar jashte kontrollit te Bankes qe nuk mund te kene qene parashikuar ne menyre te arsyeshme.

#### **3.11 Aktive te qendrueshme te trupezura**

##### **3.11.1 Njohja dhe matja**

Zerat e aktiveve te qendrueshme te trupezuara maten me kosto pakesuar me amortizimin e akumuluar dhe ndonje zhvleresim te akumuluar per humbje.

Kosto perfishin shpenzime te cilat i atribuohen direkt blerjes se aktivitetit. Kosto e aktiveve te ndertuara vete perfishin dhe koston e materialeve dhe punen direkte, kosto te tjera direkt te atribuueshme ne berjen e aktivitetit te gatshem per pune, dhe kur Banka ka detyrimin per te hequr nje aktiv apo ta restauroje ate, kosto e vleresuar e çmontimit dhe heqjes se pjese si dhe restaurimi i vendit ne te cilin ato ndodhen. Programet kompjuterike qe jane pjese e funksionimit te pajisjes ne te cilen ato jane instaluar, kapitalizohen si pjese e asaj pajisjeje.

Ne rast se pjese te nje aktiviteti kane afate perdorimi te ndryshme, ato regjistrohen si njesi me vete (perberesit kryesore) te aktiveve te trupezuara.

Te ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit te nje aktiviteti te trupezuar (llogaritur si diference midis arketimeve nga nxjerrja jashte perdorimit dhe vleres kontabel te aktivitetit) njihen si te ardhura te tjera ne pasqyren e fitimit humbjeve.

##### **3.11.2 Kostot e mepashme**

Shpenzimet e mepashme kapitalizohen vetem nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike qe i atribuohen atyre do te rrjedhin te Banka ne te ardhmen. Te gjitha kostot e tjera te riparimit dhe mirembajtjes regjistrohen ne shpenzimet kur ndodhin.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.11 Aktive te qendrueshme te trupezura (vazhdim)**

##### **3.11.3 Amortizimi**

Aktivet e qendrueshme te trupezuara amortizohen duke filluar nga dita qe ato jane vene ne perdorim, ose persa i perket aktiveve te ndertuar vete, nga dita e perfundimit dhe e berjes gati per perdorim. Amortizimi llogatitet per te gjitha jeten e aktivitet mbi koston e asetit minus vleren e tij te mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyren e fitim humbjeve.

Amortizimi i vitit eshte llogaritur sipas metodës se vleres se mbetur ne perputhje me normat e meposhtme:

	<b>Norma vjetore</b>
Paisje kompjuterike	25%
Paisje zyre	20%
Paisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

Permiresimet ne ambientet e marra me qira nga Banka amortizohen duke perdorur metoden lineare gjate kohes me te shkurter midis afatit te qirase dhe jetes se tyre. Afati i perdorimit te ketyre permiresimeve varion nga 3 ne 15 vjet. Aktivitet ne proces nuk amortizohen. Metodatat e amortizimit, jeta dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi dhe axhustohen ne rast se ka nevojë.

#### **3.12 Aktive te qendrueshme te patrupezuara**

Programet kompjuterike te blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin kur eshte i aplikueshem. Shpenzimet e mepasshme ne programe kompjuterike kapitalizohen vetem nese ato rrisin perfitimet ekonomike te ardhshme te aktivitet per te cilin behen. Te gjitha shpenzimet e tjera regjistruhen kur ndodhin.

Amortizimi njihet ne fitim humbje gjate jetes se dobishme te aktivitet, duke u nisur nga data ne te cilen eshte i vlefshem per pune. Aktivitet ne proces nuk amortizohen.

Programet kompjuterike amortizohen sipas metodës se vleres se mbetur me norme vjetore amortizimi 25%, nderkohe aktivitet e tjera te patrupezuara, qe perfshijne licenca dhe komisione te paguara per qasje ne sisteme elektronike e sherbime te perdorura nga Banka, amortizohen sipas metodës lineare me norme vjetore amortizimi 15%.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi dhe axhustohen ne rast se ka nevojë.

#### **3.13 Investime ne pasurite e paluajtshme**

Investimet ne pasuri te paluajtshme jane aktive te mbajtura ose per te fituar te ardhura nga qeraja ose per rivlersime te vleres se tyre ose per te dyja, por jo per perdorim ne prodhim apo furnizim me te mira materiale, sherbime apo per qellime administrative. Banka mban investime ne pasurite e paluajtshme si pasoje e perfitimit te tyre nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradheniet ndaj klienteve. Pasurite e paluajtshme per investim maten fillimisht me kosto dhe me pas me vleren e drejte, ku cdo ndryshim i tyre njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes ne zerin "te ardhura te tjera".

Cdo fitim apo humbje e gjeneruar gjate shitjes se pasurive te paluajtshme te mbajtura per investim (te llogaritur si diference midis te ardhurave nga shitja dhe vleres kontabel te ketij aktivitet) njihet ne pasqyren e fitimit ose humbjes. Ne rast se perdorimi i ketij aktive ndryshon ne menyre te tille qe riklasifikohet si aktiv i qendrueshem i trupezuar ose aktiv i mbajtur per shitje, vlera e drejte e tij ne momentin e riklasifikimit behet kosto e tij per regjistrimet kontabel te mepasshme.

#### **3.14 Kolateralet e marra ne pronesi nepermjet nje procesi gjyqsor**

Kolateralet e marra ne pronesi jane pasuri te paluajtshme te perfituara nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradheniet ndaj klienteve. Keto aktive mbahen per shitje pasi vlera e tyre do te merret kryesisht nga shitja e tyre. Kolateralet e marra ne pronesi maten me me te voglen e koston dhe vleren neto te realizueshme (VNR). Cdo zvogelim ne VNR njihet si nje shpenzim ne periudhen net e cilen ky zvogelim ndodh; cdo rimarrjes njihet ne pasqyren individuale te te ardhurave dhe shpenzimeve ne periudhen net e cilen rimarrja ndodh.

### **3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.15 Humbja nga zhvleresimi i aktiveve jofinanciare**

Vlera kontabel e aktiveve jofinanciare te Bankes, pervec tatimeve te shtyra, rishikohen cdo date raportimi per te percaktuar nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Ne rast se ka nje tregues te tille, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvleresimi njihet ne rast se vlera kontabel e aktivitetit eshte me e madhe se vlera e tij e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e nje aktiviteti eshte me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte duke zbritur koston per shitje. Ne percaktimin e vleres ne perdorim, flukset e vleresuara te pritshme te parase jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleren ne kohe te parase ne treg dhe risqet specifike te aktivitetit.

Humbjet per zhvleresim njihen ne pasqyren individuale te fitimit humbjeve. Humbja per zhvleresim kthehet mbrapsht deri ne masen qe vlera kontabel nuk kalon vleren e mbartur te aktivitetit, neto nga zhvleresimet e amortizimet, e cila do te ishte ne rast se nuk do te ishin njohur humbje nga zhvleresimi.

#### **3.16 Depozitat, marreveshjet e riblerjes, dhe borxhi i varur**

Depozitat, marreveshjet e riblerjes dhe borxhi i varur jane burimet e Bankes per financim.

Kur Banka shet nje aktiv financiar dhe njeheresh hyn ne nje marreveshje per te riblere kete aktiv (ose nje aktiv te ngjashem) me nje çmim fiks ne nje date te ardhshme (repo), marreveshja kontabilizohet si nje detyrim financiar, dhe aktiviteti vazhdon te njihet ne pasqyrat individuale financiare te Bankes.

#### **3.17 Provigjonet**

Provigjoni eshte njohur nese, si rezultat i ngjarjeve te meparshme, Banka ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv qe mund te matet me besueshmeri, dhe eshte e mundur qe nje dalje e perfitimeve ekonomike do te kerkohet per te shlyer detyrimin. Provigjonet jane percaktuar duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te mjeteve monetare me nje norme para tatimit e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe, sipas rastit, rreziqet specifike ndaj detyrimit. Efektet e vleres kohore nepermjet skontimeve njihen si kosto financiare.

#### **3.18 Perfitimet e punonjesve**

##### ***Planet e percaktuara te kontributeve***

Detyrimet per kontributet per planet e percaktuara te pensioneve njihen si nje shpenzim ne fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute te detyrueshme per sigurimet shoqerore per perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet lokale jane pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar.

##### ***Perfitimet afatshkurtra***

Detyrimet afatshkurtra per perfitimet e punonjesve maten ne nje baze te paskontuar dhe njihen si shpenzime kur ofrohet sherbimi. Nje provigjon eshte njohur per shumen qe pritet te paguhet si bonus afatshkurter ne para ose planeve me ndarje fitimi nese Banka ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv per te paguar kete shume si rezultat i sherbimeve te shkuara te ofruara nga punonjesi, dhe detyrimi mund te matet me besueshmeri.

#### **3.19 Adaptimi i standarteve te reja dhe atyre te rishikuara**

Standartet e meposhtme, te cilat jane kryesisht amendime te standarteve ekzistuese dhe interpretime te nxjerra nga Bordi Nderkombetar i Standarteve Kontabel jane efektive per periudhen aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Perfitimet e punonjesve”** – Percaktimi i planeve te perfitimit: Kontributet e Punonjesve (efektive per periudhat qe fillojne nga 1 korik 2014),
- **Ndryshime ne standartet e ndryshme “Permirsimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime qe rezultojne nga rishikimi vjetor qe u eshte bere SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qellim qe te shmangen mosperputhjet dhe te qartesohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet te zbatohen per periudhat vjetore qe fillojne nga data 1 korrik 2014),

*(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)*

### 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

#### 3.19 Adaptimi i standarteve te reja dhe atyre te rishikuara (vazhdim)

- **Ndryshime ne standartet e ndryshme “Permiresimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime qe rezultojne nga rishikimi vjetor qe u eshte bere SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNFR 13 dhe SNK 40), kryesisht me qellim qe te shmangen mosperputhjet dhe te qartesohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet te zbatohen per periudhat vjetore qe fillojne nga data 1 korrik 2014).
- **SNRF 14 “Rregullimi i Llogarive te Shtyra”** - (efektive duke filluar 1 Janar 2016 e ne vazhdim)
- **Ndryshime ne SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara” dhe SNRF 12 “Dhenia e informacioneve shpjeguese per perfshirje me entitete te tjera” dhe SNK 28 “Investime ne pjesemarrje dhe sipermarrje te perbashketa”** - Subjektet e investimeve: Perjashtim konsolidimi (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNRF 10 “Pasqyrat financiare te konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime ne pjesemarrje dhe sipermarrje te perbashketa”**- Shitja apo kontributi i pasurive ndermjet nje investitori dhe bashkepunatori te tij ose sipermarrje te perbashket (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNRF 11 “Marreveshjet e perbashketa”** - Kontabiliteti per blerjet e interesave ne operacionet e perbashketa (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”** - Iniciativat e zbulimit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 38 “Aktive jo-materiale”** - Sqarim i metodave te pranueshme te zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 16 “Prona, Impiantet dhe Pajisjet” dhe SNK 41 “Agrobiznesi”** - Agrobiznes: Bimet bartesi (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne SNK 27 “Pasqyrat financiare individuale”** - Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale (efektiv per periudhat vjetore qe fillojne me apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime ne standartet e ndryshme “Permiresimet e SNRF-ve (cikli 2012-2014)”** – Ndryshime qe rezultojne nga rishikimi vjetor qe u eshte bere SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qellim qe te shmangen mosperputhjet dhe te qartesohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet te zbatohen per periudhat vjetore qe fillojne nga data 1 janar 2016).

Adaptimi i ketyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar ne ndryshime per sa i perket politikave kontabel te Bankes.

#### 3.20 Deklarimet e reja kontabel

Disa standarte dhe interpretime te reja te cilat jane te detyrueshme per t'u zbatuar duke filluar nga 1 janari 2017 e ne vazhdim jane publikuar, dhe Banka nuk i ka adaptuar ende:

- **Ndryshimet ne SNRF 10 “Pasqyrat Financiare te Konsoliduara” dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i asetëve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto është përfunduar),
- **Ndryshimet ne SNK 7 "Pasqyra e Fluksit te Parase"** - Nisma Per Paraqitje (efektive per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 Janar 2017),
- **Ndryshime ne SNK 12 "Tatimet mbi te ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore te shtyra per Humbjet e Perealizuara (efektive per vjetore periudhat qe fillojne me ose pas dates 1 Janar 2017)

### 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

#### 3.20 Deklarimet e reja kontabel (vazhdim)

- **SNRF 9 "Instrumentat financiare"** – (efektive per peridhat qe fillojne nga 1 janari 2018). Ky standard i ri perdor nje menyre te vetme per te percaktuar nese nje instrument financiar duhet te matet me koston e amortizuar apo vleren e drejte, duke zevendesuar keshtu rregullat e ndryshem qe perdorte SNK 39. Metoda e perdorur nga SNRF 9 bazohet ne menyren se si Banka menaxhon instrumentat e saj financiare (modeli i saj i biznesit) dhe karakteristikat kontraktuale te flukseve monetare qe derivojne nga instrumentat financiare. Standarti i ri kerkon gjithashtu qe te perdoret nje menyre e vetme zhvleresimi, duke zevendesur keshtu metodat e ndryshme qe perdorte SNK 39. Kerkesat e reja per kontabilizimin e detyrimeve financiare trajtojne problemin e luhatshmerise ne fitimin ose humbjen qe vjen nga emetuesi duke zgjedhur keshtu matjen e borxhit me vleren e drejte. BSNK-ja vendosi te mbaje matjen ekzistuese me kosto te amortizuar per shumicen e detyrimeve, duke kufizuar ndryshimin vetem ne elemente qe lidhen me trajtimin e problematikave te kreditimit te vete entitetit. Me kerkesat e reja nje entitet qe vendos te mase detyrimet financiare me vleren e drejte duhet te paraqese vleren e ndryshimit ne vleren e drejte si rezultat i ndryshimit ne riskun e kredise te vete entitetit, ne seksionin e te ardhurave te tjera permbledhese dhe jo ta trajtoje ate si fitim apo humbje. Ndryshimet e nxjerra qe nga Nentori 2013 japin nje efekt pozitiv per sa i perket adaptimit te kontabilitetit mbrojtjes çka do lejoje kompanite te reflektojne ne pasqyrat financiare riskun e tyre te menaxhimit. Ndryshimet lejojne adresimin e te ashtuqujturit "kreditit i vet Bankes", problematike qe eshte perfshire tashme ne SNRF 9 "Instrumentat financiare" dhe qe mund te zbatohet ne menyre te izoluar pa pasur nevojën e ndryshimeve te politikave te tjera kontabel qe lidhen me instrumentat financiare.
- **SNRF 15 "Te ardhura nga Kontratat me Klientet"** dhe ndryshime te metejshme (efektive duke filluar 1 Janar 2018 e ne vazhdim),
- **SNRF 16 "Qirate"** (efektive duke filluar 1 Janar 2019 e ne vazhdim),
- **Ndryshimet ne SNK 40 "Investime në aktive afatgjata materiale"** - Transferimet e investimeve të aktiveve afatgjata materiale (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018),
- **Ndryshime ne standartet e ndryshme "Permiresimet e SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** – Ndryshime qe rezultojne nga rishikimi vjetor qe u eshte bere SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qellim qe te shmangen mosperputhjet dhe te qartesohet formulimi i standartit (ndryshimet e SNRF 12 jane te aplikueshme per periudhat vjetore qe fillojne nga data 1 janar 2017 dhe ndryshimet ne SNRF 1 dhe SNK 28 jane te aplikueshme per periudhat vjetore qe fillojne ne date 1 janar 2018),
- **KIRFN 22 "Transaksionet valutë dhe Konsiderata për avancat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)

Banka ka vendosur te mos i adaptoje keto standarde, rishikime dhe interpretime perpara datave efektive te tyre. Pervec impaktit te SNRF 9, i cili do te vleresohet nga kompania gjate vitit 2017, Banka beson se adaptimi i standarteve te reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te ketë ndikim material ne pasqyrat individuale financiare te Bankes ne periudhen fillestare te aplikimit.

### 4. PERDORIMI I VLERESIMEVE DHE GJYKIMEVE

Pergatitja e pasqyrave financiare individuale ne perputhje me SNRF kerkon nga menaxhimi qe te beje gjykime, vleresime dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave kontabel dhe shumat e raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe ato te ardhshme te cilat mund te preken nga ky ndryshim.

Menaxhimi diskuton me Komitetin e Auditimit, zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kritike kontabel te Bankes dhe aplikimin e tyre, si dhe supozimet e bera ne lidhje me paqartesite kryesore te vleresimit. Informacioni rreth pasigurise se supozimeve dhe vleresimeve qe kane nje rrezik te konsiderueshem per te rezultuar ne nje rregullim material brenda vitit te ardhshem financiar, dhe rreth gjykimeve kritike ne aplikimin e politikave kontabel qe kane efekt te konsiderueshem ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare individuale eshte sqaruar me poshte.

Keto shenime shpjeguese mbeshtesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shenimin 33).

#### **4. PERDORIMI I VLERSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)**

##### **4.1 Zhvleresimi**

Aktivet e regjistruara me kosto te amortizuar rishikohen per zhvleresim sipas menyres se pershkruar ne shenimin 3.7.7.

Perberesi specifik ne totalin e fondit per zhvleresim vlen te aktivet financiare te vleresuara individualisht per zhvleresim dhe eshte i bazuar mbi vleresimin me te mire qe ben manxhimi per vleren aktuale te flukseve monetare qe pritet te arketohen. Per te llogaritur keto flukse te parave, drejtimi i Bankes gjykon mbi situaten financiare te nje debitorit dhe vleres neto te realizueshme te ndonje kolaterali. Çdo aktiv i zhvleresuar, matet bazuar mbi cilesite e tij, dhe strategjia dhe vleresimi i flukseve te mjeteve monetare qe konsiderohen te arketueshme aprovohet ne menyre te pavarur nga funksioni i Rrezikut te Kredise.

Nje komponent kolektiv ne totalin e fondit per zhvleresim eshte percaktuar per grupet e kredive homogjene qe nuk jane individualisht te zhvleresuara.

Fondi per zhvleresim kolektiv per grupet e aktiveve qe nuk konsiderohen te rendesishme individualisht dhe ato qe jane te rendesishme individualisht, por qe nuk jane te zhvleresuara individualisht, mbulon humbjet kreditore ne portofolet e huave dhe paradhenieve dhe te investimeve te mbajtura deri ne maturim me karakteristika te ngjashme te rrezikut te kredise, kur ka evidence objektive per te sugjeruar se ato permbajne hua dhe paradhenie dhe investime te mbajtura deri ne maturim te cilat jane te zhvleresuara, por zhvleresimi individual i tyre ende nuk mund te identifikohet. Ne vleresimin e nevojës per fondin per zhvleresim kolektiv, menaxhimi i konsideron faktore te tille si cilesine e kredise, madhesine e portofolit, perqendrimet dhe faktoret ekonomike. Ne menyre qe te vleresohet fondi i kerkuar i zhvleresimit, jane bere supozime per te percaktuar menyren se si jane modeluar humbjet dhe per te percaktuar parametrat e kerkuar, bazuar ne pervojen historike dhe kushtet e tanishme ekonomike. Saktesia e fondit per zhvleresim varet nga vleresimet e flukseve monetare te pritshme dhe supozimet dhe parametrat e modelit te perdorura ne percaktimin e fondit per zhvleresime kolektive.

Nje vleresim per te pare nese nje investim ne borxhin qevritar eshte zhvleresuar mund te jete i nderlikuar. Ne berjen e nje vleresimi te tille, Banka e konsideron vleresimin e tregut te kreditimit, siç pasqyrohet ne yield-in e obligacioneve, vleresimet e agjencive te klasifikimit te kreditimit, aftesia e vendit per te hyre ne tregjet e kapitalit per leshimin e borxhit te ri, probabiliteti i ristrukturimit te borxhit duke rezultuar ne humbje te mbajtesit nepermjet faljes vullnetare apo te detyrueshme se borxhit dhe mekanizmat nderkombetare te mbeshtetjes per te siguruar mbeshtetjen e nevojshme si “huadhenes i fundit” ne ate vend po ashtu si dhe synimin, pasqyruar ne deklaratat publike, ne lidhje me gatishmerine e qeverive dhe agjencive per te perdorur keto mekanizma. Kjo perfshin nje vleresim si per thellesine e ketyre mekanizmave dhe, pavaresisht qellimit politik, nese ka kapacitet per te permbushur kriteret e kerkuara.

##### **4.2 Vlera e drejte**

Percaktimi i vleres se drejte te aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare per te cilat nuk ka asnje çmim tregu kerkon perdorimin e teknikave te vleresimit siç pershkruset ne shenimin 3.7.6. Per instrumentet financiare qe tregtohen rralle dhe kane transparence te pakte te çmimeve, vlera e drejte eshte me pak objektive, dhe kerkon shkalle te ndryshme te gjykimit ne varesi te likuiditetit, perqendrimet, pasigurise se faktoreve te tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe te tjera qe ndikojne mbi instrumentin specifik.

Banka e mat vleren e drejte duke perdorur hierarkine e meposhtme te metodave:

- Niveli 1: Çmimi i kuotuar ne treg ne nje treg aktiv per nje instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vleresimi bazuar ne inpute te vezhgueshme. Kjo kategori perfshin instrumente te vleresuara duke perdorur: çmimet e kuotuar te tregut ne tregjet aktive per instrumente te ngjashme; çmimet e kuotuar per instrumente te ngjashme ne tregje qe konsiderohen me pak se aktive; ose teknika te tjera vleresimi ku te gjithë inputet e rendesishme jane direkt ose indirekt te vezhgueshme nga te dhenat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vleresimi qe perdorin inpute te rendesishme te pavezhgueshme. Kjo kategori perfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vleresimi perfshijne inpute te cilat nuk bazohen ne te dhena te vezhgueshme dhe inputet e pavezhgueshme mund te kete nje efekt te rendesishem ne vleresimin e instrumentit. Kjo kategori perfshin instrumente qe jane vleresuar ne baze te çmimeve te kuotuar per instrumente te ngjashme, ku rregullime te rendesishme te pavezhgueshme ose supozime jane te nevojshme per te reflektuar diferencat midis instrumenteve.

Vleresimi i vleres se drejte eshte shtjelluar ne shenimin 34.

**5. ARKA DHE LLOGARI ME BANKEN QENDRORE**

Arka dhe llogarite me Banken Qendrore jane te detajuara si me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Arka	957,043	787,236
<i>Banka Qendrore:</i>		
Llogari rrjedhëse	1,412,198	166,940
Rezerva e detyrueshme	2,256,057	1,981,093
Interesi i perlllogaritur	119	265
<b>Totali</b>	<b>4,625,417</b>	<b>2,935,534</b>

Ne perputhje me kerkesat e Bankes se Shqiperise per rezervat per depozitat, Banka duhet te mbaje nje minimum prej 10% te balancave te llogarive te klienteve me maturim fillestar deri ne 24 muaj tek Banka e Shqiperise si rezerve te detyrueshme. Kjo rezerve e detyrueshme nuk eshte per perdorim ditor, megjithate bazuar ne rregulloret e aplikueshme, gjate muajit Banka mund te perdore deri ne 40% te rezerves se detyrueshme ne Lek, duke siguruar qe gjendja mesatare mujore e llogarive me Banken Qendrore (llogarite rrjedhese plus rezerva e detyrueshme) te mos jete me poshte se niveli i rezerves se detyrueshme.

**6. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT**

Depozitat dhe llogarite me bankat jane te detajuara si me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
<b>Llogari rrjedhese:</b>		
Jo-rezidente	2,573,400	3,653,125
	<b>2,573,400</b>	<b>3,653,125</b>
<b>Depozita:</b>		
Rezidente	302,845	449,824
	<b>302,845</b>	<b>449,824</b>
Llogari te tjera	23,071	22,642
Interesi i perlllogaritur	59	18
<b>Totali</b>	<b>2,899,375</b>	<b>4,125,609</b>

Depozitat me bankat rezidente maturohen ne nje periudhe nga 4 deri ne 20 dite (2015: 5 deri ne 62 dite) dhe mbartin interesa vjetore nga 0.2% deri ne 1.3% (2015: 0.1% deri ne 1.8% ne vit).

**7. BONO THESARI MBAJTUR DERI NE MATURIM**

Bonot e thesarit te mbajtura ne maturim jane emetuar nga Qeveria Shqiptare.

Bonot e thesarit sipas maturimit fillestar paraqiten si me poshte:

	<b>31 dhjetor 2016</b>			<b>31 dhjetor 2015</b>		
	<b>Vlera nominale</b>	<b>Skonto e paamortizuar</b>	<b>Vlera kontabel</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>Skonto e paamortizuar</b>	<b>Vlera kontabel</b>
3 muaj	-	-	-	50,000	(95)	49,905
6 muaj	-	-	-	210,110	(1,022)	209,088
12 muaj	1,548,550	(9,170)	1,539,380	1,520,470	(18,689)	1,501,781
<b>Totali</b>	<b>1,548,550</b>	<b>(9,170)</b>	<b>1,539,380</b>	<b>1,780,580</b>	<b>(19,806)</b>	<b>1,760,774</b>

**8. OBLIGACIONE MBAJTUR DERI NE MATURIM**

Obligacione mbajtur deri ne maturim ('Obligacionet') tregohen me poshte sipas entitetit emetues. Interesat paguhen cdo gjashte muaj.

	<b>31 dhjetor 2016</b>			
	<b>Vlera nominale</b>	<b>Skonto e paamortizuar</b>	<b>Interes i perlogaritur</b>	<b>Vlera kontabel</b>
Qeveria Shqiptare	13,047,440	(13,414)	182,139	13,216,165
Qeveri te huaja	590,885	19,025	8,825	618,735
Korporata te huaja	195,785	867	1,375	198,027
<b>Totali</b>	<b>13,834,110</b>	<b>6,478</b>	<b>192,339</b>	<b>14,032,927</b>

	<b>31 dhjetor 2015</b>			
	<b>Vlera nominale</b>	<b>Skonto e paamortizuar</b>	<b>Interes i perlogaritur</b>	<b>Vlera kontabel</b>
Qeveria Shqiptare	11,433,945	(430)	182,297	11,615,812
Qeveri te huaja	194,430	10,097	2,753	207,280
Korporata te huaja	137,280	734	1,763	139,777
<b>Totali</b>	<b>11,765,655</b>	<b>10,401</b>	<b>186,813</b>	<b>11,962,869</b>

Obligacionet e mbajtura deri ne maturim vleresohen si me poshte:

<i>Vleresimet e kompanise Moody's ose te njevllefshme</i>	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 dhjetor 2015</b>
Qeveria Shqiptare		
Vleresimi B+	902,507	915,514
I pavleresuar	12,313,658	10,700,298
Qeveri te huaja		
Vleresimi Aaa	131,487	-
Vleresimi Aa2	71,780	-
Vleresimi A1	70,435	-
Vleresimi A2	142,461	-
Vleresimi A3	202,572	207,280
Korporata te huaja		
Vleresimi Aa2	64,728	-
Vleresimi A1	133,299	69,671
Vleresimi A2	-	70,106
<b>Totali</b>	<b>14,032,927</b>	<b>11,962,869</b>

**9. HUA DHE PARADHENIE PER INSTITUCIONEVE FINANCIARE**

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Hua	991,504	433,650
Interesi i perlllogaritur	5,193	2,846
Fondi rezerve per zhvleresim nga huate dhe paradheniet	(9,626)	-
Te ardhura te shtyra	(1,473)	(200)
<b>Totali</b>	<b>985,598</b>	<b>436,296</b>

Banka ka dhene hua institucioneve financiare rezidente. Keto hua maturohen ne nje periudhe nga 1 deri ne 5 vjet (2015: 1 deri ne 5 vjet) dhe mbartin interesa nga 4.8% deri ne 5.4% ne vit (2015: 5% deri ne 5.5% ne vit).

**10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET**

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Hua me afat	14,562,949	13,884,631
Overdrafte	2,519,268	2,297,880
Te tjera paradhenie per klientet	128,935	108,677
	<b>17,211,152</b>	<b>16,291,188</b>
Interesi i perlllogaritur	89,344	94,183
Fondi rezerve per zhvleresim nga huate dhe paradheniet	(1,538,265)	(1,156,701)
Te ardhura te shtyra	(75,923)	(72,951)
<b>Totali</b>	<b>15,686,308</b>	<b>15,155,719</b>

Huate dhe paradheniet per klientet fitojne interesa si me poshte:

<b>Monedha</b>	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
LEK	2.10% - 20.0% ne vit	2.50% - 20.0% ne vit
EUR	1.17% - 15.0% ne vit	1.40% - 15.0% ne vit
USD	1.70% - 15.0% ne vit	1.60% - 15.0% ne vit.
GBP	P/A	1.60% - 2.50% ne vit

Banka ka dhene disa hua me norma interesi ne nivelet e ulta te treguara me lart, te cilat jane nen normat qe jane ofruar ne pergjithesi nga Banka, te cilat jane te mbrojtura me kolateral depozite ose u jane dhene personelit kundrejt kushteve te vecanta.

Huate dhe paradheniet sipas tipit te klientit jane paraqitur me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>		<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	
	<b>Shuma</b>	<b>%</b>	<b>Shuma</b>	<b>%</b>
Korporata	10,400,716	60%	10,187,937	63%
Individe	6,810,436	40%	6,103,251	37%
<b>Totali</b>	<b>17,211,152</b>	<b>100%</b>	<b>16,291,188</b>	<b>100%</b>

**Union Bank Sh.a****Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)***10. HUA DHE PARADHENIE PER KLIENTET (VAZHDIM)**

Levizjet ne fondin rezerve per zhvleresim nga huate dhe paradheniet jepet si me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Gjendja ne fillim te vitit	1,156,701	947,301
Provizjioni per vitin, neto	415,861	278,189
Kredi te fshira gjate vitit	(16,359)	(47,481)
Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit	(17,938)	(21,308)
<b>Gjendja ne fund te vitit</b>	<b>1,538,265</b>	<b>1,156,701</b>

Tabela e meposhtme paraqet shperndarjen e ekspozimit te kreditimit te Bankes sipas sektorit te industrise se klienteve:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>		<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	
	<b>Vlerat</b>	<b>%</b>	<b>Vlerat</b>	<b>%</b>
Pasuri e patundshme	3,851,344	22%	3,645,831	22%
Sherbime te tjera	3,025,690	18%	3,142,649	19%
Konsumatore	2,959,092	17%	2,457,420	15%
Tregeti	2,459,991	14%	2,340,870	14%
Ndertim	1,558,357	9%	1,546,816	9%
Hotele dhe restorante	873,312	5%	764,895	5%
Edukimi	854,728	5%	869,478	5%
Prodhim e transmetim energjie, gazi dhe uji	467,353	3%	243,649	2%
Transport, magazinimin dhe telekomunikacion	399,280	2%	355,736	2%
Industria perpunuese	368,115	2%	603,915	4%
Sherbime financiare	293,441	2%	254,049	2%
Bujqesi dhe pyje	100,449	1%	65,880	1%
<b>Totali</b>	<b>17,211,152</b>	<b>100%</b>	<b>16,291,188</b>	<b>100%</b>

**11. INVESTIME NE FILIALE**

Investime ne Filiale ne shumen prej 161,002 mije Lek (2015: 161,002 mije Lek ) perfaqesojne koston e te gjitha aksioneve te LandesLease Sh.a (shih shenimin 1). Deri ne 31 dhjetor 2014 Banka kishte paguar vetem 342,960 mije Lek, ndersa shuma e mbetur prej 42,042 mije Lek ishte nje garanci e mbajtur nga cmimi i blerjes i Filialit, e cila u pagua gjate 2015. Bazuar ne vendimin e aksionareve te Filialit te dates 19 shkurt 2015, dhe me aprovimin e Bankes Qendrore, kapitali aksionar i Filialit u ul me 224,000 mije Lek.

**12. AKTIVE TE PATRUPEZUARA**

	<b>Programe kompjuterike</b>	<b>Aktive te tjera te patrupezuara</b>	<b>Aktive te patrupezuara ne proces</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja ne 1 janar 2015</b>				
Kosto	241,679	40,596	26,544	308,819
Amortizim i Akumuluar	(139,630)	(28,794)	-	(168,424)
<b>Vlera neto</b>	<b>102,049</b>	<b>11,802</b>	<b>26,544</b>	<b>140,395</b>
<b>Viti qe u mbyll me 31 dhjetor 2015</b>				
Vlera neto ne fillim te vitit	102,049	11,802	26,544	140,395
Shtesa	1,408	37,066	(20,813)	17,661
Pakesime	-	(14,943)	-	(14,943)
Sistemime	(129)	-	-	(129)
Shpenzime amortizimi	(25,609)	(6,580)	-	(32,189)
Amortizim per pakesimet	-	6,086	-	6,086
Amortizim per sistemime	21	-	-	21
<b>Vlera neto ne mbyllje te vitit</b>	<b>77,740</b>	<b>33,431</b>	<b>5,731</b>	<b>116,902</b>
<b>Gjendja ne 31 dhjetor 2015</b>				
Kosto	242,958	62,719	5,731	311,408
Amortizim i akumuluar	(165,218)	(29,288)	-	(194,506)
<b>Vlera neto</b>	<b>77,740</b>	<b>33,431</b>	<b>5,731</b>	<b>116,902</b>
<b>Viti qe u mbyll me 31 dhjetor 2016</b>				
Vlera neto ne fillim te vitit	77,740	33,431	5,731	116,902
Shtesa	6,293	-	4,462	10,755
Shpenzime amortizimi	(19,909)	(5,870)	-	(25,779)
<b>Vlera neto ne mbyllje te vitit</b>	<b>64,124</b>	<b>27,561</b>	<b>10,193</b>	<b>101,878</b>
<b>Gjendja ne 31 dhjetor 2016</b>				
Kosto	249,251	62,719	10,193	322,163
Amortizim i Akumuluar	(185,127)	(35,158)	-	(220,285)
<b>Vlera neto</b>	<b>64,124</b>	<b>27,561</b>	<b>10,193</b>	<b>101,878</b>

Nen zerin "Aktive te tjera te patrupezuara" jane perfshire pagesat e kryera ne lidhje me sistemet e suportimit te rrjetit te ATM-ve, dhe instalimi, sherbimet e personalizimit dhe certifikimit, dhe ngritja e lidhjes on-line ndermjet sistemeve te procesorit per ATM-te dhe atij te Bankes, si dhe pagesat e kryera ndaj SWIFT per anetaresim, nderlidhje dhe qasje ne rrjet. Nxjerrjet jashte perdorimit gjate 2015, me vleren 14,943 lekë perfaqesojne vleren e paamortizuar te pagesave te bera per sherbimin e meparshem te procesimit te kartave.

**Union Bank Sh.a**
**Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016**
*(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)*
**13. AKTIVE TE TRUPEZUARA**

	<b>Pajisje kompjuterike</b>	<b>Pajisje elektronike</b>	<b>Pajisje zyre</b>	<b>Te tjera</b>	<b>Aktive te qendrueshme ne proces</b>	<b>Investime ne ambiente me qira</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja ne 1 janar 2015</b>							
Kosto	189,110	107,812	51,270	3,331	4,827	185,732	542,082
Amortizim i akumuluar	(144,845)	(70,843)	(33,664)	(1,906)	-	(107,035)	(358,293)
<b>Vlera neto</b>	<b>44,265</b>	<b>36,969</b>	<b>17,606</b>	<b>1,425</b>	<b>4,827</b>	<b>78,697</b>	<b>183,789</b>
<b>Viti qe u mbyll me 31 dhjetor 2015</b>							
Vlera neto ne fillim te vitit	44,265	36,969	17,606	1,425	4,827	78,697	183,789
Shtesa	17,492	17,389	3,816	-	7,897	6,420	53,014
Pakesime	(2,208)	(6,191)	-	-	-	(4,338)	(12,737)
Shpenzime amortizimi	(13,693)	(9,212)	(3,314)	(69)	-	(12,728)	(39,016)
Amortizim per pakesimet	1,983	4,930	-	-	-	3,235	10,148
<b>Vlera neto ne mbyllje te vitit</b>	<b>47,839</b>	<b>43,885</b>	<b>18,108</b>	<b>1,356</b>	<b>12,724</b>	<b>71,286</b>	<b>195,198</b>
<b>Gjendja ne 31 dhjetor 2015</b>							
Kosto	204,394	119,010	55,086	3,331	12,724	187,814	582,359
Amortizim i akumuluar	(156,555)	(75,125)	(36,978)	(1,975)	-	(116,528)	(387,161)
<b>Vlera neto</b>	<b>47,839</b>	<b>43,885</b>	<b>18,108</b>	<b>1,356</b>	<b>12,724</b>	<b>71,286</b>	<b>195,198</b>
<b>Viti qe u mbyll me 31 dhjetor 2016</b>							
Vlera neto ne fillim te vitit	47,839	43,885	18,108	1,356	12,724	71,286	195,198
Shtesa	15,224	12,432	8,242	-	(3,971)	27,966	59,893
Pakesime	(42,362)	(3,133)	(2,304)	-	-	(4,689)	(52,488)
Shpenzime amortizimi	(13,673)	(9,712)	(4,231)	(55)	-	(13,065)	(40,736)
Amortizim per pakesimet	39,171	2,645	1,964	-	-	4,123	47,903
<b>Vlera neto ne mbyllje te vitit</b>	<b>46,199</b>	<b>46,117</b>	<b>21,779</b>	<b>1,301</b>	<b>8,753</b>	<b>85,621</b>	<b>209,770</b>
<b>Gjendja ne 31 dhjetor 2016</b>							
Kosto	177,256	128,309	61,024	3,331	8,753	211,092	589,765
Amortizim i akumuluar	(131,057)	(82,192)	(39,245)	(2,030)	-	(125,471)	(379,995)
<b>Vlera neto</b>	<b>46,199</b>	<b>46,117</b>	<b>21,779</b>	<b>1,301</b>	<b>8,753</b>	<b>85,621</b>	<b>209,770</b>

Investimet ne aktive te marra me qira jane te lidhura me shpenzimet e bera nga Banka per rikonstruksionin e ambjenteve degeve dhe zyrave qendrore te marra me qira nga Banka. Nuk ka asnjë aktiv të vendosur si kolateral më 31 dhjetor 2016 (2015: asnjë).

**14. INVESTIM NE PASURI TE PALUAJTSHME**

Banka mban investime ne pasuri te paluajtshme si pasoje e perfitimit te tyre nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradheniet ndaj klienteve.

Totali i te ardhurave nga qiradhenia e pasurive te paluajtshme gjate vitit 2016 ishte 3,168 mije Lek (2015: 20,161 mije Lek).

**Matja e vleres se drejte – Hierarkia e vleres se drejte**

Vlera e drejte e investimeve ne pasuri te paluajtshme u percaktua nga vleresues te pasurive, te cilet kane kualifikimet profesionale dhe eksperienca ne vendodhjen dhe kategorite e pasurive qe vleresohen. Vleresuesit percaktojne vleren e drejte te pasurive te paluajtshme te Bankes cdo vit.

Vlera e drejte e investimeve ne pasuri te paluajtshme te Bankes kategorizohet ne Nivelin 3 te hierarkise se vleres se drejte.

**Niveli 3 i vleres se drejte**

Tabela e meposhtme tregon nje levizje te gjendjes nga fillimi deri ne fund te vitit per matjen e vleres se drejte te investimeve ne pasuri te paluajtshme te Bankes te mbajtura per investim.

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
<b>Gjendja ne 1 janar</b>	<b>347,944</b>	<b>641,592</b>
Transferuar nga kolaterale e marra ne pronesi (shenimi 15)	82,082	69,317
Perfituar gjate vitit	10,458	12,349
Transferuar ne kolaterale e marra ne pronesi (shenimi 15)	(45,062)	(357,697)
Ndryshimet ne vleren e drejte, neto (te parealizuar)	(19,167)	(12,143)
Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit	(3,465)	(5,474)
<b>Gjendja ne 31 dhjetor</b>	<b>372,790</b>	<b>347,944</b>

**Teknikat e vleresimit dhe inputet e rendesishme jo te vrojtueshme**

Tabela e meposhtme tregon tekniken e vleresimit te perdorur me matjen e vleres se drejte te investimeve ne pasuri te paluajtshme, si dhe te inputeve te rendesishme jo te vrojtueshme te perdorura.

**Teknika e vleresimit**

Referimi ne tregun aktual:  
Modeli i vleresimit perdor cmime dhe informacione te tjera te rendesishme te gjeneruara nga transaksione qe perfshijne aktive, detyrime, ose grupe aktivesh dhe detyrimesh identike apo te krahasueshme (te ngjashme) (psh nje biznes)

**Inpute te rendesishme jo te vrojtueshme**

- Cmimet e tregut modifikohen per te reflektuar sa me poshte:
- Nivelin e trasaksioneve ne treg kur aktiviteti eshte i ulet apo cmimi per nje pasuri identike eshte i veshitore per t'u gjetur.
  - Kushtet specifike te seciles pasuri (ndertimi, pozicioni etj.)

**15. AKTIVE TE TJERA**

Aktive te tjera detajohen me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Kolaterale te marra ne pronesi	354,020	403,550
Debitore te ndryshem	266,720	306,979
Vlera monetare ne tranzit	154,218	81,389
Te ardhura te perlllogaritura	21,183	14,438
Parapagime	12,033	18,493
Depozita garancie te paguara	4,208	686
Furnitore te arketueshem	3,597	-
Inventare	3,511	3,304
Pagesa ne tranzit	1,136	906
<b>Totali</b>	<b>820,626</b>	<b>829,745</b>

Kolaterale e marra ne pronesi jane pasuri te patundshme te perfituara nepermjet ekzekutimit te kolateraleve mbi kredite dhe paradheniet ndaj klienteve. Banka synon dhe eshte duke ndermarre hapa per te shitur keto aktive me oferten me te mire.

Tabela e meposhtme tregon nje levizje te gjendjes nga fillimi deri ne fund te vitit per kolaterale e marra ne pronesi nga Banka

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
<b>Gjendja ne 1 janar</b>	<b>403,550</b>	<b>316,903</b>
Transferuar ne investime ne pasuri te paluajtshme (shenimi 14)	(82,082)	(69,317)
Te perfituara gjate vitit	12,208	160,482
Te blera gjate vitit	-	233,376
Transferuar nga investimet ne pasuri te paluajtshme (shenimi 14)	45,062	357,697
Aktive te shitura gjate vitit	(12,032)	(581,064)
Ndryshimi ne VNR, neto	(9,445)	(6,737)
Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit	(3,241)	(7,790)
<b>Gjendja ne 31 dhjetor</b>	<b>354,020</b>	<b>403,550</b>

Gjate vitit 2015, Banka nenshkroi nje kontrate shitjeje per nje nga keto aktive me vlere rreth 568,340 mije Lek, e cila ishte pjeserisht ne pronesi dhe te nje banke tjeter. Per te mundesuar transaksionin e shitjes, Banka fillimisht bleu kete pjese dhe me pas e shiti pronen me nje fitim prej 91,087 mije Lek, vlere kjo qe u njoh ne pasqyren individuale te fitim humbjes te vitit 2015 (shenimi 26).

Gjate dhjetorit 2014, Banka nenshkroi nje kontrate shitjeje per nje nga aktivet e mesiperme te mbajtura per shitje me vleren prej 130 milione Lek. Cmimi ishte i pagueshem ne 12 keste mujore. Kjo kontrate u revokua ne dhjetor 2015 per shkak te paqartesisve te bleresit dhe si rrjedhoje, shuma garantuese e kesaj kontrate prej 17,805 mije Lek, u njoh si e ardhur ne pasqyrat individuale te fitim humbjes te vitit 2015 (shenimi 26).

Ne 13 shkurt 2015, gjate procesit te transportimit te vlerave monetare, i cili manaxhohet nga nje pale e trete profesionale e licencuar, eskorta u sulmua jashte zyrave te Bankes nga persona te paidentifikuar te armatosur. Shuma potenciale eshte e siguruar plotesisht brenda polices se sigurimit 'Bankers Blanket Bond' dhe Drejtimi beson qe pjesa ende e parimbursuar e kesaj vlere do te meret plotesisht. Debitore te ndryshem perfshin dhe shumen ne fjale.

Vlera monetare ne tranzit perfaqesojne vlere te shitura me bankat korrespondente data e likuidimit e te cilave, sipas marreveshjes, bie ne ditet e para te vitit pasardhes.

**16. DETYRIME NDAJ BANKES QENDRORE**

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
Bono thesari te shitura me marreveshje riblerje	2,167,067	1,315,740
Interesi i perlllogaritur	1,505	1,822
<b>Totali</b>	<b>2,168,572</b>	<b>1,317,562</b>

Bono thesari te shitura me marreveshje riblerje "Repo" jane instrumenta te perdorura per manaxhimin e likuiditetit afatshkurter te emetuara nga Banka Qendrore me qellim shtimin e likuiditetit ne sistemin bankar. Repot ne fund te vitit 2016 bartnin interes ne normat e tregut qe varionin nga 1.35% deri 1.4% ne vit (2015: 1.77% deri 2.16% ne vit) dhe ishin te gjitha ne Lek.

**17. DETYRIME NDAJ BANKAVE E INSTITUCIONEVE FINANCIARE**

Detyrimet ndaj bankave e institucioneve financiare jane te detajuara si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>Llogari rrjedhese</b>		
Rezidente	643,705	634,980
Jo-rezidente	343,115	290,477
	<b>986,820</b>	<b>925,457</b>
<b>Depozita me afat</b>		
Rezidente	232,520	235,326
Jo-rezidente	43,531	43,930
	<b>276,051</b>	<b>279,256</b>
<b>Hua te marra</b>		
Rezidente	128,170	-
	<b>128,170</b>	<b>-</b>
<b>Llogari te tjera</b>		
Rezidente	1,858	106,765
	<b>1,858</b>	<b>106,765</b>
Interesi i perlllogaritur	1,663	2,684
<b>Totali</b>	<b>1,394,562</b>	<b>1,314,162</b>

Ne llogarite rrjedhese te institucioneve financiare perfshihen dhe 377 milione Lek (2015: 402 milione Lek) te depozituara nga Unioni Financiar Tirane ("UFT"), nga te cilat 101 milione Lek (2015: 103 milione Lek) jane vendosur si kolateral per kredite e leshuara nga Banka per palet e lidhura.

Llogarite rrjedhese te institucioneve financiare jo-rezidente perfshijne balancat e depozituara nga 'Union of Financial Corners' dhe 'Unioni Financiar Prishtine', te dyja pale te lidhura me Banken, me vlere rreth 207 milion LEK (2015: 278 milion LEK).

Depozitat me afat nga institucionet financiare jo-rezidente jane depozita njevjecare nga 'Union of Financial Corners', nje pale e lidhur me Banken, prej 43,274 mijë lekë (2015, 43,930 mijë lekë), te cilat mbahen si kolateral per kredite e dhena nga Banka, dhe mbartin interesa me norme vjetore 0.6% ne vit (2015: 0.7% ne vit).

Huate e marra perfaqesojne hua afatshkurtra marre nga bankat rezidente ne USD, ne shuma 128 milione Lek (2015: zero) me nje maturim fillestar 7 dite dhe me norma interesi qe variojne nga 07% ne 0.9% ne vit.

**18. DETYRIME NDAJ KLIENTEVE**

Detyrimet ndaj klienteve te ndara ne ato te ndermarrjeve, sipermarrjesve private dhe individeve, perbehen nga llogari rrjedhese dhe llogari depozitash dhe jane paraqitur si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2016	Më 31 dhjetor 2015
<b>Llogari te Qeverise dhe administrates publike:</b>		
Monedhe vendase	349,053	288,148
Monedhe e huaj	29,155	109,437
	<b>378,208</b>	<b>397,585</b>
<b>Llogari rrjedhese:</b>		
Monedhe vendase	2,525,457	2,365,722
Monedhe e huaj	3,322,654	2,665,289
	<b>5,848,111</b>	<b>5,031,011</b>
<b>Depozita pa afat:</b>		
Monedhe vendase	1,238,776	1,126,370
Monedhe e huaj	3,044,890	2,354,705
	<b>4,283,666</b>	<b>3,481,075</b>
<b>Depozita me afat:</b>		
Monedhe vendase	12,556,932	12,563,306
Monedhe e huaj	9,631,788	8,603,139
	<b>22,188,720</b>	<b>21,166,445</b>
<b>Llogari te tjera te klienteve:</b>		
Monedhe vendase	361,813	307,916
Monedhe e huaj	709,505	808,108
	<b>1,071,318</b>	<b>1,116,024</b>
Interes i parapaguar per depozitat e klienteve	(138)	(327)
Interesi i përlllogaritur	324,087	426,454
<b>Totali</b>	<b>34,093,972</b>	<b>31,618,267</b>

Llogarite rrjedhese dhe depozitat pa afat ne monedha te ndryshme mbartin interes qe varion nga 0.1% deri 0.7% ne vit. (2015: 0.1% ne vit deri 1% ne vit) dhe depozitat me afat mbartin interes si me poshte:

Monedha	2015	2015
LEK	0.20% deri 4.60% ne vit	0.90% deri 7.60% ne vit
EUR	0.05% deri 2.50% ne vit	0.10% deri 4.40% ne vit
USD	0.10% deri 1.20% ne vit	0.20% deri 1.90% ne vit
GBP	0.05% deri 0.50% ne vit	0.20% deri 0.70% ne vit

Llogari te tjera te klienteve perfaqesojne llogari te bllokuara per tendera/garanci kontrate, garanci te tjera bankare dhe per kapital fillestar te bllokuara nga klientet ne procesin e themelimit te kompanive te tyre.

**Union Bank Sh.a****Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)***18. DETYRIME NDAJ KLIENTEVE (VAZHDIM)**

Llogarite dhe depozitat e klienteve te analizuara sipas produkteve paraqiten si me poshte:

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	LEK	Monedhe e huaj	Totali	LEK	Monedhe e huaj	Totali
<b>Llogari te Qeverise dhe administrates publike</b>						
Pa afat	349,053	29,155	378,208	278,148	33,708	311,856
Dymbedhete mujore	-	-	-	10,000	75,729	85,729
<b>Totali llogari te Qeverise dhe administrates publike</b>	<b>349,053</b>	<b>29,155</b>	<b>378,208</b>	<b>288,148</b>	<b>109,437</b>	<b>397,585</b>
<b>Llogari rrjedhese</b>	<b>2,525,457</b>	<b>3,322,654</b>	<b>5,848,111</b>	<b>2,365,722</b>	<b>2,665,289</b>	<b>5,031,011</b>
<b>Depozita pa afat</b>	<b>1,238,776</b>	<b>3,044,890</b>	<b>4,283,666</b>	<b>1,126,370</b>	<b>2,354,705</b>	<b>3,481,075</b>
<b>Depozita me afat:</b>						
Tre mujore	301,746	429,412	731,158	434,197	481,087	915,284
Gjashte mujore	560,672	517,571	1,078,243	672,521	480,051	1,152,572
Dymbedhete mujore	3,004,365	3,517,979	6,522,344	3,477,715	3,545,969	7,023,684
Katermbedhete mujore	1,052,312	741,761	1,794,073	1,265,857	897,575	2,163,432
Njzetepese mujore	1,445,473	822,632	2,268,105	2,020,616	1,096,885	3,117,501
Tridhjetepese mujore	3,114,105	1,516,031	4,630,136	3,164,686	1,281,421	4,446,107
Gjashtedhete mujore	1,820,255	1,016,880	2,837,135	1,183,148	709,026	1,892,174
Depozita te tjera	1,258,004	1,069,522	2,327,526	344,566	111,125	455,691
<b>Totali i depozitave</b>	<b>12,556,932</b>	<b>9,631,788</b>	<b>22,188,720</b>	<b>12,563,306</b>	<b>8,603,139</b>	<b>21,166,445</b>
<b>Llogari te tjera te klienteve:</b>						
Pa afat	39,404	10,954	50,358	25,141	11,394	36,535
Tre mujore	12,736	135	12,871	12,736	-	12,736
Gjashte mujore	-	-	-	1,120	-	1,120
Dymbedhete mujore	23,130	49,806	72,936	14,058	57,514	71,572
Te tjera	286,543	648,610	935,153	254,861	739,200	994,061
<b>Totali i llogarive te tjera</b>	<b>361,813</b>	<b>709,505</b>	<b>1,071,318</b>	<b>307,916</b>	<b>808,108</b>	<b>1,116,024</b>
<b>Totali</b>	<b>17,032,031</b>	<b>16,737,992</b>	<b>33,770,023</b>	<b>16,651,462</b>	<b>14,540,678</b>	<b>31,192,140</b>

"Depozita te tjera" perfshin depozitat me maturim fillestar 10 muaj, 11 muaj dhe 24 muaj. "Te tjera" perfshijne kryesisht balancat e llogarive te notereve te perdorura per transakcionet me Zyren e Pasurive te Paluajtshme.

## 19. DETYRIME TE TJERA

Detyrime te tjera eshte e detajuar si me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Pagesa ne transit	176,988	291,380
Furnitore per fatura ne mberritje	30,058	24,979
Kredi nga qeveria	12,087	-
Te ardhura te shtyra dhe shpenzime te perllogaritura	5,175	3,992
Provizjione te tjera per rreziqe dhe shpenzime	961	984
Te tjera	20,523	28,181
<b>Total</b>	<b>245,792</b>	<b>349,516</b>

Pagesat ne tranzit perfaqesojne transfertat nderkombetare ne nisje, data e likuidimit e te cilave sipas marreveshjes bie ne ditet e para te vitit pasardhes.

Banka, si pjese e “Programit per Zhvillimin e Sektorit Privat Shqiptar” ka marre fonde si nje kredi nga Ministria e Ekonomise me qellim financimin e projekteve te SME-ve ne Shqiperi. Vlera ne zerin “Kredi nga qeveria” perfaqeson balancen e mbetur te kesaj kredie. Kjo kredi ka nje maturim fillestar prej 5 vitesh dhe mbart interes me norme 0.5% ne vit.

## 20. KAPITALI AKSIONAR

Bazuar ne Vendimin e Asamblese se Aksionareve te dates 30 qershor 2015, kapitali i nenshkruar u rrit me 100 mije aksione nepermjet kontributeve te UFT (aksionarit kryesor te Bankes). Pagesa e kesaj rritjeje u be ne tre transhe:

- 8 korrik 2015: 25 mije aksione me vlere totale 34,905 mije Lek;
- 27 nentor 2015: 30 mije aksione me vlere totale 41,445 mije Lek; dhe
- 24 dhjetor 2015: 45 mije aksione me vlere totale 61,610 mije Lek.

Me 31 dhjetor 2016, kapitali i nenshkruar ishte i ndare ne 2,097,143 aksione (2015: 2,097,143 aksione) me vlere nominale 10 EUR secili, nderkohe qe levizjet ne kapitalin e paguar ne 2016 dhe 2015 ishin si me poshte:

	<b>31 dhjetor 2016</b>		<b>31 dhjetor 2015</b>	
	<b>Nr. i aksioneve</b>	<b>Vlera e Aksioneve</b>	<b>Nr. i aksioneve</b>	<b>Vlera e aksioneve</b>
Gjendja ne fillim te vitit	2,097,143	2,717,813	1,997,143	2,579,853
Rritja e kapitalit gjate vitit	-	-	100,000	137,960
<b>Kapitali i paguar</b>	<b>2,097,143</b>	<b>2,717,813</b>	<b>2,097,143</b>	<b>2,717,813</b>

Struktura e kapitalit te nenshkruar:

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Unioni Financiar Tirane Sh.p.k (UFT)	86.34%	86.34%
Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH)	10.12%	10.12%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Kapitali i paguar perbehet nga aksione te cilat nuk jane preferenciale dhe nuk ka kufizime mbi to.

Bazuar ne Vendimin e Asamblese se Aksionareve te dates 30 qershor 2016, nga fitimi i 2015, u krijua rezerva ligjore per shumen 154,173 Lek (2015: 117,733 Lek). Pjesa e mbetur e tij u vendos te mbahej per investime.

**21. TE ARDHURA NGA INTERESAT**

Te ardhurat nga interesi jane fituar nga aktivet e meposhtme:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Hua dhe paradhenie per klientet	1,183,722	1,253,315
Investime ne letra me vlere	744,147	749,362
Hua dhe paradhenie per institucionet financiare	35,687	15,118
Depozita dhe llogari me bankat	10,850	15,964
<b>Totali</b>	<b>1,974,406</b>	<b>2,033,759</b>

Te ardhurat nga interesat perfshijne dhe ato ne vleren 114,512 mije Lek (2015: 114,467 mije LEK) qe jane interesa te njohura nga kredite te zhvlersuara individualisht.

**22. SHPENZIME PER INTERESAT**

Shpenzimet per interesat jane gjeneruar nga detyrimet e meposhtme:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Detyrime ndaj klienteve	386,210	506,050
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	10,293	9,500
Marreveshje te riblerjes	10,005	24,387
Te tjera	85	15
<b>Totali</b>	<b>406,593</b>	<b>539,952</b>

**23. TE ARDHURA NGA KOMISIONET**

Komisionet e marra jane te detajuara si me poshte:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Sherbime bankare	185,250	152,801
Nga aktiviteti huadhenies	14,500	8,206
Te tjera	18,360	26,235
<b>Totali</b>	<b>218,110</b>	<b>187,242</b>

**24. SHPENZIME PER KOMISIONET**

Komisionet e paguara jane te detajuara si me poshte:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Sherbime bankare	18,346	9,386
Veprimet e thesarit	2,815	6,926
Te tjera	10,794	10,447
<b>Totali</b>	<b>31,955</b>	<b>26,759</b>

**25. REZULTATI NETO NGA VEPRIMET VALUTORE**

Rezultati neto nga veprimet valutore paraqet fitimin nga kembimet valutore si dhe rivleresimin pozicioneve te hapura valutore ne monedhe te huaj. Rezultati neto nga veprimet valutore per 2016 ishte fitim prej 10,530 mije Lek (2015: humbje 11,422 mije Lek). Efekti i rivlerësimit të pozicionit të hapur në fund të vitit për kapitalin e paguar-të aksioneve (në Euro) ishte humbja prej 45,920 mijë Lekë (2015: humbja me 61,883 mijë lekë)

**26. TE ARDHURA TE TJERA, NETO**

Te ardhura te tjera neto, perfshijne te ardhura dhe shpenzime ne veprime te tjera bankare, fitimin ose humbjen e rezultuar nga shitja e asetëve fikse, te ardhurat nga ripagimet e kredive te fshira etj. Te ardhura te tjera ne vleren 16,242 mije Lek (2015: 106,382 mije Lek) perfshijne dhe fitimin e realizuar nga shitja e nje aktivi ne vleren 8,081 mije Lek (2015: 91,087 mije Lek (shenimi 15) dhe fitimi i realizuar nga ekzekutimi i garancise se mbajtur per nje kontrate shitjeje e cila u revokua nga bleresi ne vleren 17,805 mije Lek (shenimi 15).

**27. SHPENZIME PERSONELI**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime per paga	379,684	343,064
Shpenzime per sigurime shoqerore	44,643	41,550
<b>Totali</b>	<b>424,327</b>	<b>384,614</b>

Me 31 dhjetor 2016 Banka kishte 362 punonjes (2015: 337).

**28. SHPENZIME TE TJERA ADMINISTRATIVE**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Qira	190,230	169,766
Sherbime te tjera te jashtme te ofruara nga te tretet	111,297	89,610
Shpenzime te primit te sigurimit te depozitave	88,242	82,604
Shpenzime marketingu	36,925	31,772
Shpenzime komunikimi	35,671	42,343
Mirembajtja e programeve kompjuterike	34,691	30,939
Sherbime per sigurine	31,874	31,116
Utilitete, energji elektrike, uje	22,288	22,221
Materiale zyre e te tjera	17,620	17,497
Mirembajtja dhe riparime	15,317	16,157
Shpenzime transporti	9,006	8,583
Shpenzime legale dhe konsulence	8,874	20,914
Shpenzime per sigurime	4,557	4,100
Pagesa per anetaret e bordit	4,434	4,569
Shpenzime perfaqesimi	2,352	1,679
Trajnime	2,012	1,442
<b>Totali</b>	<b>612,390</b>	<b>575,312</b>

Sherbime te tjera te jashtme te ofruara nga te tretet perfshijne shpenzime te lidhura ne sherbimet e kartave te debitit dhe kreditit te ofruara nga MasterCard Europe SA, shpenzime per personalizimet e kartave, shpenzime per taksat lokale, shpenzime per shtypshkrime te personalizuar etj.

**29. TATIMI MBI FITIMIN**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzim tatim fitimi	38,948	71,407
Te ardhura nga tatimi i shtyre	(4,203)	(2,413)
<b>Totali i tatimit mbi fitimin</b>	<b>34,745</b>	<b>68,994</b>

Tatimi mbi fitimin eshte 15% (2015: 15%) e fitimit te tatueshem.

**29. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Me poshte jepet rakordimi i fitimit kontabel me ate te tatueshem:

	Norma efektive e tatimit	2016	Norma efektive e tatimit	2015
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>210,062</b>		<b>441,213</b>
Tatim fitimi ne 15%	15.0%	31,509	15.0%	66,182
Shpenzime te panjohura:	1.5%	3,239	0.5%	2,310
Te ardhura te perjashtuara nga tatim fitimi:	(0.2%)	(3)	0.1%	502
<b>Shpenzim tatim fitimi</b>	<b>16.5%</b>	<b>34,745</b>	<b>15.6%</b>	<b>68,994</b>

Me poshte detajohet kalimi nga fitimi sipas SNRF-ve ne ate te tatueshem dhe tatim fitimin e vitit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>210,062</b>	<b>441,213</b>
Te ardhura/ shpenzime jo te tatueshme:	27,997	19,444
Levizjet ne perberesit e tatimit te shtyre	28,020	16,096
- Zhvleresim i aktiveve te mbajtura per shitje	9,445	6,737
- Ndryshim ne vleren e drejte te pasurive te paluajtshme	19,167	12,143
- Fitim nga shitja e kolateraleve te marra ne pronesi	(239)	(2,784)
- Efekti i rivleresimit te kolateraleve te marra ne pronesi	(353)	
Te ardhura te perjashtuara nga tatimi	(23)	3,348
- Rimarrje provigjonesh	(23)	-
- Shmangia e tatimit te dyfishte	-	3,348
Shpenzime te panjohura:	21,595	15,392
- Shpenzime te personelit	5,909	4,379
- Gjoha	3,129	2,263
- Te tjera	12,557	8,750
<b>Fitimi tatimor</b>	<b>259,654</b>	<b>476,049</b>
<b>Tatimi i vitit ne 15%</b>	<b>38,948</b>	<b>71,407</b>
Tatimi vitit nga jorezidentet (kreditim i tatimit te huaj)	211	813
Tatimi i vitit nga rezidentet	<b>38,737</b>	<b>70,594</b>

Tatimet e shtyra llogariten me normen 15% qe eshte norma tatimore ne fuqi per vitin 2016. Aktivitet tatimore te shtyra njihen ne baze te parashikimit qe ben drejtimi per fitimin e tatueshem ne vitet ne vazhdim, i cili do te mund te perdoret per mbulimin e humbjeve.

Levizjet ne aktivet tatimore te shtyra paraqiten me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Aktiv tatimor i shtyre ne fillim te vitit	4,110	1,697
Takse e shtyre njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve	4,203	2,413
<b>Aktiv tatimor i shtyre ne fund te vitit</b>	<b>8,313</b>	<b>4,110</b>

**29. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Aktivitet dhe detyrimet tatimore te shtyra vijne nga zerat e meposhtem:

	<b>2016</b>	<b>Njohur ne te ardhura dhe shpenzime</b>	<b>2015</b>	<b>Njohur ne te ardhura dhe shpenzime</b>	<b>2014</b>
<b>Aktiv tatimor i shtyre:</b>					
Aktive afatgjata per shitje	3,307	1,634	1,673	580	1,093
Investim ne pasuri te paluajtshme	5,006	2,569	2,437	1,833	604
	<b>8,313</b>	<b>4,203</b>	<b>4,110</b>	<b>2,413</b>	<b>1,697</b>

Mbeshtetur ne Ligjin per kontabilitetin, duke filluar nga data 1 janar 2008, Banka duhet te raportoje ne perputhje me SNRF. Ligji Nr. 10364, date 16.12.2010, paraqiti ndryshime, (te cilat jane ne fuqi qe nga 24 janar 2011). Sipas ketyre ndryshimeve, humbjet nga zhvleresimi i huave dhe paradhenieve te klienteve te njohura sipas SNRF-ve, do te konsiderohen si shpenzime te njohura per efekte tatimore, ne rast se jane te certifikuara nga auditoret e jashtem dhe nuk kalojne shpenzimet per provigjone te caktuara sipas Bankes Qendrore.

Tatim fitimi i parapaguhet autoritetit tatimor shqiptar me keste mujore. Per eliminimin e tatimit te dyfishte, tatimi i vitit qe rezulton nga marrdhenia me jorezidentet (kreditimi i tatimit te huaj), mbahet nga autoritetet tatimore jorezidente nepermjet pageses mujore te interesave. Keto parapagime ulin shumen e tatim fitimit te pagueshem ne fund te vitit raportues. Me poshte tregohet detyrimi per tatim fitimi ndaj autoriteteve tatimore, duke marre ne konsiderate shumet e parapaguara ne vitet respektive.

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
<b>Detyrimi per tatim fitimin 1 janar</b>	<b>48,830</b>	<b>20,423</b>
Tatim fitimi i paguar (i detyrueshem ne fund te vitit paraardhes)	(48,830)	(20,423)
Tatim fitimi i parapaguar autoritetit tatimor shqiptar	(56,933)	(21,764)
Tatim fitimi i parapaguar jorezidenteve (kreditim i tatimit te huaj)	(211)	(813)
Shpenzim tatim fitimi	38,948	71,407
<b>Tatim fitimi i parapaguar/i detyrueshem me 31 dhjetor</b>	<b>(18,196)</b>	<b>48,830</b>

**30. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ**

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshin si me poshte:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
Arka	957,043	787,236
Llogari me Banken Qendrore	1,412,198	166,940
Balanca me institucione financiare me maturim deri ne 3 muaj	2,876,245	3,762,949
Bono thesari me maturim deri ne 3 muaj	-	49,905
<b>Totali</b>	<b>5,245,486</b>	<b>4,767,030</b>

### 31. VEPRIME ME PALET E LIDHURA

Palet quhen te lidhura kur njera prej tyre ka mundesine te kontrolloje palet e tjera ose te ushtroje ndikim domethenes ne vendim-marrjen financiare dhe operacionale te tyre.

Per te vleresuar cdo maredhenie te mundshme te paleve te lidhura, vemendja i eshte kushtuar thelbit te marredhenies dhe jo vetem anes ligjore te saj.

Banka ka marredhenie me pale te lidhura si aksionaret dhe shoqerite e lidhura, filialet (Landeslease sha) e stafin drejtues. Struktura e aksionareve te Bankes me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet ne shenimin 20. Unioni Financiar Tirane ("UFT") eshte aksionari fundor i Bankes.

Subjektet e lidhura me Banken (qe zoterohen ne menyre direkte apo jo nga UFT) perfshijne Union Distribucion Servis Albania Shpk, Media Union Shpk, Union Travel Shpk, Albanian Courier Shpk, United Transport, Union Group Shpk, Uni-Com Sha, Albanian Cargo Service Shpk, Auto Master Sha, United Motors Shpk, S-Systems Sha, Atex Shpk, Auto City Sha, Pluton Investor Shpk, Arch Investor Shpk, Union Of Financial Corners, Plus Communication, Auto Net Shpk, Press Point El, Uni-Cons Shpk, Union Net Shpk, Paylink Sha, Union of Financial Corners sa, Unioni Financiar Prishtine, Expo City shpk, ASL Construc 2 shpk, E-ticketing systems, Union net Kroaci, Prestige Service Shpk, Digit-alb sha.

Ne datat respektive te mbylljeve te raportimit, Banka ka gjendjet e meposhtme me palet e lidhura:

	<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015</b>
<b>Aktivet:</b>		
Hua dhe paradhenie dhene klienteve:		
Aksionare te tjere	1,694	1,271
Filiale	740,530	436,496
Shoqeri te lidhura	1,225,719	1,254,728
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	96,910	107,702
Mjete te tjera:		
Shoqeria meme	186	420
Aksionare te tjere	3	1
Filiale	1	1
Shoqeri te lidhura	2,266	996
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	19	6
<b>Detyrimet:</b>		
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare:		
Shoqeria meme	376,964	402,459
Filiale	4,305	196
Shoqeri te lidhura	250,384	322,524
Detyrime ndaj klienteve:		
Aksionare te tjere	66,371	74,205
Shoqeri te lidhura	403,939	378,765
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	211,340	181,915
Detyrime te tjera:		
Shoqeria meme	203	206
Aksionare te tjere	203	206
Filiale	8	
Shoqeri te lidhura	7,200	4,528
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	585	1

Huate dhe paradheniet dhene shoqerive te lidhura ne shumen 1,225,719 mije Lek (2015: 1,254,728 mije Lek) jane te mbuluara me fonde likuide 548,491 mije Lek (2015: 727,605 mije Lek) dhe pjesa e mbetur me kolaterale te tjera te vendosura nga shoqeria meme dhe shoqerite e grupit.

**31. VEPRIMET ME PALET E LIDHURA (VAZHDIM)**

Banka ka kryer keto veprime me palet e lidhura:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Te ardhura nga interesat:		
Shoqeria meme	-	-
Aksionare te tjere	228	386
Filiale	28,104	15,468
Shoqeri te lidhura	48,332	59,605
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	5,573	5,985
Shpenzime per interesa:		
Shoqeria meme	-	15
Aksionare te tjere	93	124
Filiale	-	10
Shoqeri te lidhura	2,755	3,127
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	856	1,932
Te ardhurat nga komisionet:		
Shoqeria meme	2,522	4,431
Aksionare te tjere	254	142
Filiale	139	415
Shoqeri te lidhura	4,354	3,225
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	394	328
Te ardhura operative:		
Shoqeri te lidhura	1,943	162
Shpenzime operative:		
Shoqeria meme	2,470	2,511
Aksionare te tjere	4,712	73,631
Shoqeri te lidhura	141,171	34,033
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	75,181	45,927
Shitja e aktiveve fikse:		
Shoqeri te lidhura	246	-
Blerja e aktiveve fikse:		
Shoqeri te lidhura	13,128	6,644

**31. VEPRIMET ME PALET E LIDHURA (VAZHDIM)**

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
<b>Zerat jashte bilancit:</b>		
Linja kreditimi te dhena nga Banka te paperdorura:		
Aksionare te tjere	10,152	8,749
Filiale	67,615	66,604
Shoqeri te lidhura	16,013	14,070
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	9,861	8,209
Garanci te marra:		
Shoqeria meme	101,443	102,980
Aksionare te tjere	188,716	197,292
Filiale	689,673	700,128
Shoqeri te lidhura	2,242,865	1,673,085
Stafi manaxhues i Bankes apo memes dhe te aferm te tyre	173,718	208,316
Garanci te dhena:		
Shoqeria meme	20	20
Shoqeri te lidhura	10,657	1,561

**32- ANGAZHIME DHE DETYRIME TE MUNDSHME**

Angazhimet dhe detyrimet e mundshme perfshijne zerat me poshte:

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Garanci te dhena ne favor te klienteve	236,462	280,321
Angazhime per overdrafte te paperdorura	1,096,482	1,082,736
Angazhime per Leter kredi	24,209	22,785

**Garanci dhe angazhime**

Banka leshon garanci per klientet e saj. Keto instrumenta mbartin risk te njejte me kredite e dhena. Garancite e marra prej klienteve dhe institucioneve financiare perfshijne kolateral ne fonde likuide, hipoteka te bllokuara ne favor te Bankes prej huamarresve te saj.

Angazhimet perfaqesojne shumat e paterhequra te limitit te kredive, overdrafteve dhe kartave te kreditit qe u jane dhene klienteve.

**Ceshtje ligjore**

Ne 31 dhjetor 2016 Banka ka qene e perfshire ne ceshtje ligjore te nje natyre qe konsiderohet normale ne biznesin e saj. Niveli i ketyre ceshtjeve ligjore korrespondon me nivelin e tyre ne vitet e meparshme. Drejtimi i Bankes mendon se keto ceshtje ligjore qe jane pezull nuk do te shkaktojne humbje materiale.

**Angazhime qiraje**

Banka eshte angazhuar ne kontrata qeraje te pa-anullueshme. Keto angazhime perbehen si me poshte:

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Deri ne 1 vit	108,184	103,066
<b>Totali</b>	<b>108,184</b>	<b>103,066</b>

### **33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANICAR**

Veprimtarite e Bankes e ekspozojne ate ndaj nje sere rreziqesh financiare dhe keto veprimtari perfshijne analizen, vleresimin, pranimin dhe administrimin deri ne nje mase te rreziqeve ose kombinimit te tyre. Marrja persiper e rrezikut eshte ne qender te biznesit financiar nderkohe qe rreziqet operacionale jane nje rrjedhoje e pashmangshme e te qenit ne biznes. Per pasoje, qellimi i Bankes eshte arritja e nje balance te pershtatshme ndermjet rrezikut dhe fitimit dhe minimizimi i efekteve te mundshme kercenuese ne performancen e Bankes.

Politikat e Bankes lidhur me administrimin e rrezikut jane hartuar ne menyre qe te identifikojne dhe analizojne keto rreziqe, te vendosin limite te pershtatshme dhe kontrole te rrezikut, si dhe te monitorojne risqet dhe permbajtjen ndaj limiteve me ane te sistemeve te besueshme dhe te perditesuara te informacionit.

Llojet me te rendesishme te rrezikut jane diskutuar me poshte.

#### **(a) Rreziku i kredise**

Rreziku i kredise eshte rreziku qe pala tjetere e nje instrumenti financiar te deshtojte ne ripagimin e detyrimit dhe t'i shkaktojte Bankes humbje. Banka eshte subjekt i rrezikut te kredise nepermjet veprimtarise se saj kredituese dhe investuese, dhe ne rastet kur ajo vepron si ndermjetese ne emer te klienteve ose paleve te treta kur leshon garanci, ne kete rast, rreziku i kredise buron nga mundesia qe pale te ndryshme te mund te deshtojne ne permbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Bazuar ne politikat e aprovuara nga Bordi Drejtues, Komiteti i Kredise te Bankes eshte pergjegjes per menaxhimin e rrezikut te kredise. Pervec kesaj Departamenti i Kredise ne Banke i raporton Drejtorit Ekzekutiv ne Banke, dhe eshte pergjegjes per menaxhimin e rrezikut te kredise, duke perfshire:

- Hartimin e politikave te kredise ne konsultim me njesite e biznesit, duke perfshire kerkesat e mbulimit te kolateralit, vleresimin e kredise, raportimin dhe nivelet e rrezikut, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe perputhshmerine me kerkesat rregulatore dhe statutore.
- Vendosjen e strukturave te autorizimit per aprovimin dhe rinovimin e linjave te kreditimit. Aprovimi dhe rinovimi i linjave te kreditimit kerkojne aprovim nga Departamentit te Kredise, Drejtuesi i departamentit te Kredise, Komiteti i Kredise te Bankes ose Bordi Drejtues, sipas niveleve te percaktuara.
- Rishikimin dhe vleresimin e rrezikut te kredise. Departamenti i kredise ne Banke vlereson te gjitha ekspozimet e kreditit qe tejkalojne limitet e percaktuara, perpara angazhimit per kreditim ndaj njesive te biznesit te perfshira. Rinovimet dhe rishikimet e limiteve jane subjekte te njejtij proces rishikimi.
- Kufizimin e perqendrimit te ekspozimit ndaj kunderpartive, vendodhjes gjeografike dhe llojit te industrise (per kredi dhe paradhenie).
- Zhvillimi dhe mbajtja e niveleve te rrezikut ne Banke me qellim kategorizimin e ekspozimeve sipas shkalleve te humbjes financiare te ndodhur dhe per t'i terhequr vemendjen drejtimit drejt rreziqeve te tjera. Sistemi i niveleve te rrezikut eshte perdorur ne percaktimin nese provigjione per zhvleresimin mund te kerkohen ndaj ekspozimeve specifike te kredise. Struktura aktuale e niveleve te rrezikut konsiston ne dhjete nivele duke reflektuar nivele te ndryshme te rrezikut te mospageses dhe vlefshmerise se kolateralit ose zbutes te tjere te ketij rreziku. Pergjegjesia e percaktimit te niveleve te rrezikut shkon me aprovimin final te ekzekutivit/komitetit, sipas percaktimeve. Nivelet e rrezikut jane subjekt i rishikimeve te rregullta nga Drejtimi Ekzekutiv i Bankes.
- Rishikimi i perputhjes se njesive se biznesit me limitet e ekspozimit te rena dakord. Raporte te rregullta /periodike mbi cilesine e kredise u jepen Departamentit te Kredise ne Banke, ne menyre qe te marrin masa veprimi me pas.
- Dhenia e keshillave, udhezimeve dhe aftesive teknike njesive te biznesit, per te perhapur praktiken me te mire ne banke ne lidhje me administrimin e rrezikut te kredise.

Cdo njesi biznesi i kerkohet te zbatoje politikat dhe procedurat e kredise ne Banke me autoritetin e aprovimit te kredise te deleguar nga Departamenti i Kredise dhe Komiteti i Kredise. Cdo njesi biznesi ka nje punonjes pergjegjes, i cili raporton per te gjitha ceshtjet lidhur me kredine ndaj drejtuesve lokale dhe Komitetit te Kredise ne Banke.

**33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(a) Rreziku i kredise (vazhdim)**

Cdo njesi biznesi eshte pergjegjese per cilesine dhe performancen e portofolit te saj te kredise dhe per monitorimin dhe kontrollin e risqeve te kredise ne portofolin e saj, perfshire dhe ato qe jane subjekt i aprovimit ne qender. Per me teper, kontrole te rregullta te njesive te biznesit dhe proceseve te Kredise ne Banke ndermerren nga Kontrolli i Brendshem.

Bazuar ne politikat e aprovuara nga Bordi Drejtues, Komiteti i Manaxhimit te Aktiv Pasiveve te Bankes eshte pergjegjes per menaxhimin e rrezikut te kredise te lidhur me investimet. Pervec kesaj Departamenti i Thesarit, qe raporton ne Drejtorin Financiar ne Banke dhe Departamenti i Riskut qe raporton ne Drejtorin e Pergjithshem ne Banke, jane pergjegjes per monitorimin e riskut te kredise qe lidhet me investimet e Bankes.

*Ekspozimi maksimal i kredise*

Ekspozimi maksimal i rrezikut te kredise perpara kolateraleve te mbajtura ose permiresimeve te tjera te kredise eshte si me poshte:

	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Bono Thesari te mbajtura deri ne maturim	1,539,380	1,760,774
Obligacione mbajtur deri ne maturim	2,899,375	11,962,869
Depozita dhe llogari me bankat	985,598	4,125,609
Kredi dhe paradhenie institucioneve financiare	15,686,308	436,296
Kredi dhe paradhenie klientëve	14,032,927	15,155,719
Garanci financiare	236,462	280,321
Angazhime te dhena per leter kredi	24,209	22,785
Angazhime te dhena per kreditim	1,096,482	1,082,736
<b>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut te kredise</b>	<b>36,500,741</b>	<b>34,827,109</b>

Ekspozimi ndaj rrezikut te kredise administrohet gjithashtu pjeserisht nga marrja e kolateraleve dhe garancive. Llojet kryesore te kolateraleve jane:

- Prona hipotekore ose rezidenciale
- Pengje mbi aktivet dhe inventaret e bizneseve
- Depozita dhe llogari te vendosure ne banke (kolateral ne mjete monetare)
- Garante personale per kredine

Pervec kredive me afat dhe overdrafteve te biznesit qe jane siguruar nga llojet e mesiperme te kolateralit, banka jep gjithashtu overdrafte ne llogarite e pages per individet. Per sa kohe qe pagesat mujore te pagave kompensojne pjesen e perdorur te limitit te dhene per keto lloj paradheniesh nuk merren pengje. Garancite financiare dhe letrat ne pritje te kredise jane te kolateralizuara me mjete monetare.

**Kredi dhe paradhenie te zhvleresuara**

Kredite dhe paradheniet te zhvleresuara jane kredi dhe paradhenie per te cilat Banka percakton se eshte e mundshme se ajo do jete e paafte te mbledhe tere principalin dhe interesat sipas kushteve kontraktuale te marreveshjes(ve) te kredise.

**Kredi ne vonese por jo te zhvleresuara**

Kredite dhe paradheniet per te cilat interesi kontraktual ose pagesat e principalit jane ne vonese, por Banka beson se zhvleresimi nuk eshte i pershtatshem ne baze te nivelit te sigurise/ kolateralit te vlefshem, dhe/ ose fazes se mbledhjes se shumave ne detyrim te klientit.

**Kredite me kushte te rinegociueshme**

Kredite me kushte te rinegociueshme jane kredi qe jane ristrukturuar si pasoje e perkeqesimit te pozitive financiare te klientit dhe per te cilat banka ka bere leshime te cilat perndryshe nuk do t'i kishte konsideruar. Ne momentin qe kredia eshte ristrukturuar, ajo qendron ne kete kategori pavaresisht nga performanca e kenaqshme eventuale pas ristrukturimit.

**Union Bank Sh.a****Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)***33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(a) Rreziku i kredise (vazhdim)****Fondet rezerve per zhvleresim**

Banka vendos nje fond rezerve per humbjet nga zhvleresimet e kredive qe perfaqesojne vleresimin e nivelit te humbjeve te pesuara ne portofolin e saj te kredise. Kjo ka te beje me perberesit specifike te humbjes qe u takojne ekspozimeve individuale me domethenese. Kredite dhe paradheniet jane permblodhur si me poshte:

**31 dhjetor 2016**

	<b>Kredi dhe paradhenie klienteve</b>				<b>Kredi dhe paradhenie institucioneve financiare</b>	<b>Vendosjet dhe balancat me bankat</b>
	<b>Individe</b>	<b>Korporata</b>	<b>Paradhenie</b>	<b>Totali</b>		
Pa vonese e as te zhvlerësuar	5,146,867	4,864,764	1,908,893	11,920,524	995,223	2,899,375
Ne vonese por jo te zhvlerësuar	1,041,015	1,094,617	411,857	2,547,489	-	-
Individualisht te zhvlerësuar	344,375	2,070,742	341,443	2,756,560	-	-
<b>Totali Bruto</b>	<b>6,532,257</b>	<b>8,030,123</b>	<b>2,662,193</b>	<b>17,224,573</b>	<b>995,223</b>	<b>2,899,375</b>
Minus: zhvleresimi per kredite individualisht te zhvlerësuar	151,549	778,156	237,708	1,167,413	-	-
Minus: zhvleresimi per kredite kolektivisht te zhvlerësuar	66,223	219,380	85,249	370,852	9,626	-
<b>Totali i rezervave per zhvleresim</b>	<b>217,772</b>	<b>997,536</b>	<b>322,957</b>	<b>1,538,265</b>	<b>9,626</b>	<b>-</b>

**31 dhjetor 2015**

	<b>Kredi dhe paradhenie klienteve</b>				<b>Kredi dhe paradhenie institucioneve financiare</b>	<b>Vendosjet dhe balancat me bankat</b>
	<b>Individe</b>	<b>Korporata</b>	<b>Paradhenie</b>	<b>Totali</b>		
Pa vonese e as te zhvlerësuar	4,499,994	4,705,465	1,895,965	11,101,424	436,296	4,125,609
Ne vonese por jo te zhvlerësuar	970,530	1,823,223	122,534	2,916,287	-	-
Individualisht te zhvlerësuar	367,257	1,524,308	403,144	2,294,709	-	-
<b>Totali Bruto</b>	<b>5,837,781</b>	<b>8,052,996</b>	<b>2,421,643</b>	<b>16,312,420</b>	<b>436,296</b>	<b>4,125,609</b>
Minus: zhvleresimi per kredite individualisht te zhvlerësuar	142,514	477,965	238,404	858,883	-	-
Minus: zhvleresimi per kredite kolektivisht te zhvlerësuar	58,772	190,454	48,592	297,818	-	-
<b>Totali i rezervave per zhvleresim</b>	<b>201,286</b>	<b>668,419</b>	<b>286,996</b>	<b>1,156,701</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Union Bank Sh.a**

**Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016**

*(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)*

**33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(a) Rreziku i kredise (vazhdim)**

*Kredi dhe paradhenie as ne vonese dhe as te zhvleresuara*

Bazuar ne klasifikimin e brendshem te kredise se Bankes, kredite dhe paradheniet qe nuk jane as ne vonese dhe as te zhvleresuara jane klasifikuar si me poshte:

**31 dhjetor 2016**

Rating	Kredi dhe paradhenie klienteve				Kredi dhe paradhenie institucioneve financiare	Vendosjet dhe balancat me bankat
	Individe	Korporata	Paradhenie	Totali		
Mire	5,105,538	4,594,023	1,856,272	11,555,833	995,223	2,899,375
Pranueshem	41,329	270,741	52,621	364,691	-	-
Monitorim i ngushte	-	-	-	-	-	-
Te Papranueshme	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>5,146,867</b>	<b>4,864,764</b>	<b>1,908,893</b>	<b>11,920,524</b>	<b>995,223</b>	<b>2,899,375</b>

**31 dhjetor 2015**

Rating	Kredi dhe paradhenie klienteve				Kredi dhe paradhenie institucioneve financiare	Vendosjet dhe balancat me bankat
	Individe	Korporata	Paradhenie	Totali		
Mire	4,456,114	4,616,396	1,863,689	10,936,199	436,296	4,125,609
Pranueshem	43,880	89,069	32,276	165,225	-	-
Monitorim i ngushte	-	-	-	-	-	-
Te Papranueshme	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>4,499,994</b>	<b>4,705,465</b>	<b>1,895,965</b>	<b>11,101,424</b>	<b>436,296</b>	<b>4,125,609</b>

**Union Bank Sh.a****Shenime per pasqyrat financiare individuale me dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016***(Te gjitha vlerat jane shprehur ne mije Lek, pervecse kur shprehet ndryshe)***33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(a) Rreziku i kredise (vazhdim)***Kredi dhe paradhenie ne vonese por jo te zhvleresuara*

Me poshte jepet analiza e moshes se kredive ne vonese por jo individualisht te zhvleresuara.

**Me 31 dhjetor 2016****Banda kohore**

Ne vonese deri 30 dite

Ne vonese 31-60 dite

Ne vonese 61-90 dite

Ne vonese 91-180 dite

Ne vonese mbi 180 dite

**Totali****Vleresimi i vleres se drejte te kolateralit**

	<b>Kredi dhe paradhenie klienteve</b>			
	<b>Individe</b>	<b>Korporata</b>	<b>Paradhenie</b>	<b>Totali</b>
Ne vonese deri 30 dite	734,030	781,928	43,629	1,559,587
Ne vonese 31-60 dite	166,542	103,123	205,116	474,781
Ne vonese 61-90 dite	140,009	207,432	78,756	426,197
Ne vonese 91-180 dite	434	2,134	82,789	85,357
Ne vonese mbi 180 dite	-	-	1,567	1,567
<b>Totali</b>	<b>1,041,015</b>	<b>1,094,617</b>	<b>411,857</b>	<b>2,547,489</b>
<b>Vleresimi i vleres se drejte te kolateralit</b>	<b>2,738,247</b>	<b>5,066,677</b>	<b>1,251,860</b>	<b>9,056,784</b>

